**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

# V E N D I M

**K.P.P. 37/2021**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

| | |
|---|---|
| Jonaid Myzyri | Kryetar |
| Enkeleda Bega | Nënkryetar |
| Vilma Zhupaj | Anëtar |
| Merita Zeqaj | Anëtar |

Në mbledhjen e dates 22.01.2021, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Modifikimi i dokumentave të proçedurës së prokurimit me Nr.REF-81931-12-14-2020 me objekt: "*Rikonstruksion i godinës së Spitalit Prrenjas Librazhd*", me fond limit 25.000.000 lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 15.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.

**Ankimues:** **"**Shtatori 90" sh.p.k
Nj.B 10, Rr. "Myslym Shyri", NP 5/96, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:** Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd
Rruga "Jahup Biçaku" lagja Nr 2, Librazhd

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik",* i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të*

*Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19".*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim dhe pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**Vëren:**

**I**

*Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

**II**

*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 15.12.2020 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit me Nr.REF-81931-12-14-2020 me objekt: "*Rikonstruksion i godinës së Spitalit Prrenjas Librazhd*", me fond limit 25.000.000 lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 15.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.

II.2. Në datën 16.12.2020 operatori ekonomik "Shtatori 90" sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kërkuar modifikimin e dokumentave të proçedurës së mësipërme të prokurimit. Konkretisht pretendohet si vijon:

*"Ne daten 15.12.2020 eshte publikuar ne sistemin elektronik procedura me numer REF-81931-12-14-2020 me objekt Rikonstruksion i godines se Spitalit Prrenjas Librazhd me autoritet kontraktor Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd parashikuar per tu zhvilluar ne date 15.01.2021 me fond limit 25.000.000 (njezetepesemilion) leke pa TVSH. Nga shqyrtimi i dokumentave te tenderit, projekt preventivit, specifikimet teknike, relacionet, projektet*

*konstatojme se kriteret per kualifikim jane hartuar ne kundershtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, ne tejkalim te kapaciteteve qe kerkon ekzekutimi i procedures.*
*Autoriteti kontraktor pervecse ka tejkaluar objektin e prokurimit ka pershkruar ne te te dhena te tjera qe nuk perkojne asbolutisht me asnje te dhene mbi objektin. Ne hartimin e ketyre kritereve autoriteti kontraktor eshte treguar diskriminues, tendencioz, haptazi kufizues dhe eshte perpjekur, ne tejkalim te ligjit, te ule pjesemarrjen e operatoreve ekonomike duke hartuar kritere ne menyre preferenciale ne menyre konfuzuese per operatoret e tjere. Ju bejme me dije se, bazuar ne frymen e ligjit dhe ne respektim te tij "Autoriteti kontraktor hartimin e kritereve duhet ta beje ne menyre gjitheperfshirese, duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidateve e ofertuesve. Nje nder parimet kryesore te zhvillimit te procedures jane ato te transparences dhe trajtimit te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike dhe duke qene se kriteret kane tejkaluar objektin e prokurimit me poshte po ju parashtojme konstatimet tona mbeshtetur ne LPP,VKM mbi prokurimin publik.*
*Se pari ngreme pretendimin dhe kundershtojme piken 2.3.2 Operatoret ekonomike duhet te deshmojne se disponojne license profesonale per zbatim punimesh ne ndertim si dhe per kategorite e nevojshme per zbatimin e kontrates.*
*NP.I - B, NP.2 -B, NP.3 - B, NP.12- B, NS.2-B, NS.3-B, NS.4-B, NS.8 - B NS.9-B, NS.10- B, NS.12-B, NS.13 – B, NS.14-B, NS.18 -B, NS.19 –A.*
*Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008; Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi", i ndryshuar.*
*Licenca lidhur me ekzekutimin e punimeve:[...]*
*Ju bejme me dije se "Klasifikimi paraprak i shoqerive ndertimore sipas niveleve per cdo kategori punimesh zbatimi" te Vendimi i Keshillit te Ministrave nr. 42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", i ndryshuar, parashikohet: NIVELI I SHOQERISE SIPAS VLERAVE NE LEKE TE PUNIMEVE TE KRYERA PER CDO KATEGORI PUNIMI*
*A ( edhe per here te pare) 0-20 milion leke 10*
*B 21-50 milion leke*
*C 51-100 milion leke*
*D 101-200 milion leke*
*E 201-400 milion leke*
*F 401-800 milion leke*
*G mbi 800 milion leke*
*Pasi analizuam me kujdes projektin, preventivin dhe specifikimet teknike te publikuara ne SPE per kete objekt prokurimi, konstatojme se vendosja e kategorizimit eshte bere pa u bazuar ne nje analize teknike mbi vlerat e projekt preventivit.*
*Ne kuptim te: Nenit 46/1/b te LPP, ne te cilin parashikohet se:"Operatoret ekonomike, per te marre pjese ne procedurat e prokurimit, duhet te kualifikohen, pasi te kene permbushur te gjitha*

*kriteret e meposhtme, qe autoriteti/kontraktor i vlereson te nevojshme, per sa kohe qe ato jane ne per pjesetim me natyren dhe permasat e kontrates qe do te prokurohet dhe jodiskriminuese", Pikes 5 te nenit 26 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 ku parashikohet se: " ... Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me afiesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates Kerkojme Autoritetit kontraktor t'i permbahet percaktimeve ligjore dhe te kryeje modifikimin e pikave si me poshte:*

*BEHET:*

*NP.1 - A, NP.2 - B , NP.3 - B, NP.12 - A, NS.2- B, NS.3-B, NS.4 -B, NS.8 – A, NS.9 - A, NS.10- A, NS.12 -A, NS.13 - A, NS.14 - B, NS.18 -A, NS.19 – A.*

*Se dyti kundershtojme piken: Per te provuar se ka pervoje e duhur, Operatori duhet te deshmoje se ka te punesuar mesatarisht te pakten 110 (njqind e dhjete) punonjes, me kohe te plote, per periudhen Janar 2020 - Tetor 2020 te deshmuar me;*

*a. Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj ne periudhen e mesiperme.*

*b. List pagesat e punonjesve te plotesuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per secilin nga muajt ne periudhen e mesiperme.*

*Autoriteti kontraktor hartimin e kritereve duhet ta beje ne menyre gjitheperfshirese duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidateve e ofertuesve. Nje nder parimet kryesore te zhvillimit te procedures jane ato te transparences dhe trajtimit te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike.*

*Theksojme kriteri per fuqine punetore i sherben autoritetit kontraktor per te provuar vetem kapacitetet teknike dhe profesionale te operatorit ekonomik, qe vleresohen te nevojshme per te realizuar kontraten qe prokurohet. Ky kriter nuk eshte pjese e kritere qe vertetojne eksperienca te suksesshme ne realizimin e punimeve dhe duke iu permbajtur edhe te rekomandimit nr 6732 prot date 21.10.2020 te APP ne kete rast autoriteti kontraktor jo vetem qe nuk ka hartuar analize teknike te numrit te puntorise ne raport me punimet dhe afatin e realizimit te tyre por qartazi dhe haptazi ka injoruar dhe s'ka marre fare parasysh respektimin e LPP dhe VKM nr 914. Ne vleresimin tone kerkesa e AKper fuqine punetore duhet te behet ne funksion te qellimit per te cilin kerkohet (per realizimin e objektit konkret te prokurimit". [...]*

*Gjykojme se e rendesishme per autoritetin kontraktor eshte qe te vertetohet disponimi i punonjesve ne momentin e zhvillimit te procedures se prokurimit dhe periudhen e zbatimit te punimeve sipas kontrates objekt prokurimi. Per aq kohe sa vertetohet se ata jane te punesuar prane operatorit ekonomik ne perputhje me parashikimet e Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise, si dhe figurojne ne listepagesa ne perputhje me legjislacionin, cili eshte motivi qe autoriteti kontraktor kerkon qe keta punonjes te jene me kohe te plote pune?*

*Ne piken 5, te nenit 26, te VKM nr.914, date 29.12.2014 parashikohet qe cdo kriter i vecante duhet te jete ne perputhje me natyren dhe permasen e kontrates. Marre shkas nga tipologjia e objektit te kontrates qe prokurohet, punimet konkrete te parashikuara dhe volumet e tyre, gjykojme se AK duhet te rishikoje kete kerkese pasi eshte diskriminuese dhe kufizuese per operatoret ekonomik te interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.*

*Kerkojme uljen e numrit te punonjesve ne 52 punonjes dhe heqjen e kerkeses qe keta punonjes te jene me kohe te plote sipas vendimit te KPP vendimi or 322/2019 date 28.05.2019.*

*Se treti kundershtojme piken Pjese e stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise:*

| | |
|---|---|
| *Inxhinier Ndertimi* | *2 (dy)* |
| *Inxhinier Elektronik* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Mjedisi* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Hidroteknik* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Gjeodet* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Elektrik* | *2 (nje)* |
| *Inxhinier Mekanik* | *1 (nje)* |
| *Arkitekt* | *2 (dy)* |

*Secili prej pjestareve te drejtuesve teknik te mesiperm, duhet te jete ne Listepagesat te pakten per periudhen Janar 2020 - Tetor 2020 si dhe te figurojne ne licensen e shoqerise.*

*Per secilin prej pjesetareve te stafit duhet te paraqitet:*

*- kontrate noteriale pune e vlefshme- diploma*

*Referuar tipologjise se objektit qe do te prokurohet, punimeve te percaktuara ne preventiv, veprimtarise konkrete te punimeve e cila eshte e perqendruar ne nje kantier te vetem, per cfare arsye e mbi c'analize teknike autoriteti kontraktor ka kerkuar Inxhinier Ndertimi 2 (dy), Arkitekt 2 (dy), Inxhinier Elektrik 2nje)*

*Autoriteti kontraktor eshte ne shkelje te hapur me nenin 26 pika 5 VKM nr 914 date 29.12.2014, ku parashikohet qe" ... kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesise zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates". Konstojme se kriteri i mesiperm nuk eshte ne perputhje dhe proporcion me natyren dhe volumin e kontrates dhe si nje kriter i tille duhet ndryshuar. Per me teper kemi te bejme me nje kantier te vetem ne lidhje me diponueshmerine e dy inxhinierve ndertimi drejtues teknik, 2 inxhiniere elektrik, 2 arkitekt, gjykojme se ne hartimin e kritereve te vecanta te kualifikimit, ne respekt te nenit 46 pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar autoriteti kontraktor duhet te parashikoje kritere kualifikuese ne perputhje me natyren dhe volumin e kontrates. AK si parakusht sine qua non per hartimin dhe vendosjen e kritereve te vecanta te kualifikimit duhet qe keto te fundit ti hartoje ne perputhje me natyren e kontrates dhe volumin e punimve. Sa me siper, referuar natyres se kontrates, volumit te kryerjes se punimeve, llojit te punimeve te kerkuar, si edhe kategorizimit te pikave te licences, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmeria e 2 inxhiniere ndertimi, 2 inxhiniere elektrik, 2 arkitekt si pjese e stafit teknik.*

*Ky kriter eshte qartazi dhe haptazi i hartuar qellimisht ne menyre abuzive dhe ne shkelje te ligjit vetem per te realizuar kufizimin e pjesemarrjes se operatoreve ekonomike te interesuar pasi objekti qe prokurohet eshte nje objekt i vetem.*

*Kerkojme modifikimin e ketij kriteri dhe inxhinieret e mesiperm te kerkohen si staf mbeshtetes.*

*BEHET:*

*Pjese e stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise:*

| | |
|---|---|
| *Inxhinier Ndertimi* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Elektronik* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Mjedisi* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Hidroteknik* | *1 (nje)* |
| *Inxhinier Gjeodet* | *1 (nje)* |

*Inxhinier Elektrik 1 (nje)*
*Inxhinier Mekanik 1 (nje)*
*Arkitekt 1 (nje)*

*Secili prej pjestareve te drejtuesve teknik te mesiperm, duhet te jete ne Listepagesat te pakten per periudhen Janar 2020 - Tetor 2020 si dhe te figurojne ne licensen e shoqerise.*

*Per secilin prej pjesetareve te stafit duhet te paraqitet:*

*- kontrate noteriale pune e vlefshme*

*- diploma*

*Se katerti kundershtojme piken: e. Krahas stafit te mesiperm te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*

*- Inxhinier Ndertimi projili strukturist-1;*
*- Inxhinier Telekomunikacion - 1;*
*-Teknik Gjeometer -1;*
*-Teknik Hidroteknike - 1*
*-Teknik ndertimi - 3;*
*-Teknik Topograf-1;*
*-Teknik Mekanik -3;*
*- Agranom -1;*
*- Hekurkthyes -1;*
*- Hidraulik -2;*
*-Murator- 2*
*-Suvatues - 2*
*-Specialist kamerash -2*
*-Specialist lT - 2*
*-Ndertimtari -1*
*- Elektricist -2;*
*- Bojaxhi -1;*
*- Karpentier -2;*
*- Pllakashtrues -1;*
*- Specialist per ndihmen e pare -1;*
*- Specialist Saldator -4*
*-Specialist Sistem Ngrohje Ftohje -1*
*-Automakinist - 2;*
*-Shofer - 4;*
*- Eskavatorist me goma dhe zinxhir/Manovrator - 5;*

*Operatori ekonomik te paraqes per stafin e mesiperm kontratat noteriale te punes, diplome dhe ose kualifikimin perkates per secilin punonjes. Deshmia e kualifikimit dhe/ose diploma te jete e leshuar nga institucione te licensuara shteterore Arsimore Profesionale. Stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht muajt e fundit (Shtator 2020-Tetor 2020-Nentor 2020).*

** Mos paraqitja e kontrave te nenshkruara perpara noterit mes paleve kontratore do te jete kusht skualifikues.*

** Ne rastin e paraqitjes se kontratave kolektive detyrimisht te jene konform nenit 160 te Kodit te Punes sipas parashikimeve ligjore ne fuqi.*

*Dhe nje here ju veme ne dukje qe duhet ti permbaheni frymes dhe parimeve ligjore. Pikes 5 te nenit 26 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 ku parashikohet se:" ... Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates." Ky kriter i vendosur nga ana e autoritetit kontraktor qe nuk eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin qe prokurohet kerkojme te saktesoni numrin e kerkuar per punonjesin teknik gjeometer. Per reference vendimi nr 322/2019 date 28.05.2019 KPP.*

*Mbeshtetur ne ligjin nr. 7961, date 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punes, Kreu V, neni 12, specifikohet: Kontrata e punes eshte nje marreveshje ndermjet punemarresit dhe punedhenesit, qe rregullon marredheniet e punes dhe permban te drejtat dhe detyrimet e paleve. Ne kontraten e punes punemarresi merr persiper te ofroje punen ose sherbimin e vet per nje periudhe te caktuar ose te pacaktuar kohe, ne kuader te organizimit dhe te urdhrave te nje personi tjeter, te quajtur punedhenes, i cili merr persiper te paguaje nje shperblim. Ligji nuk e ka te percaktuar formen noteriale te lidhjes se kontrates, mjafton forma e rregullt ligjore ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne kodin e punes.*

*Gjithashtu lejohet lidhja e kontratave ndermjet punedhenesit dhe punemarresit me kohe te pjesshme dhe ky i fundit gezon te njejtat te drejta si punemarresit me kohe te plote.*

*Referuar neni 21 te Kodit te Pones thuhet ne menyre te shprehur se:Kontrata e punes mund te lidhet me goje ose me shkrim. Ajo mundte ndryshohet vetem ne marreveshje midis paleve. Cdo ndryshim i kontrates se shkruar, ne dem te punemarresit, duhet te perfundohet me shkrim,"; me sa shihet nuk ka nje moment ku te jete shprehur per domosdoshmerine e formes ad substantiam me akt noterial. Garancia ligjore qe ligji i ka vene kesaj kontrate eshte maksimalisht me shkrese, pra pranohet dhe verbalisht. Duke u nisur nga kjo dispozite ne kuptojrne se ligjvenesi ka dashur te lehtesoje sa me shume proceduren e kontraktimit te punemarresit, si per favorizim te ketij te fundit po ashtu edhe lehtesi te punedhenesit. Ratio leges i mos kushtezimit te formes se kontrates se punes eshte shume i kuptueshem, pasi ligji duhet t'i vije ne ndihme subjektit dhe jo anasjelltas, qe do te thote nuk mund te shpjegohet perforcimi i standarteve te vendosura nga Autoriteti Kontraktor, kur legjislatori ka maksimizuar formen deri ne kontraten me shkrim. Sipas teorise te se drejtes ne lidhje me formen e veprimit juridik, domosdoshmeria e saj eshte per te provuar vullnetin e paleve ne kete marredhenie, ne rastin konkret ligjvenesi kushtezohet ne formen verbale ose me shkrese, duke lene ne vleresim te paleve zgjedhjen e formes ose me goje ose me shkrim por jo me shume se sa kaq, pasi e ka gjetur me vend se mund te sjelle pasoja juridike ky veprim juridik mjafton me kete te jete ne mirebesim mes paleve deri ne nivelin e shkreses se nenshkruar bashkarisht.*

*Nder te tjera sjellim ne Vemendjen Tuaj se ky kriter bie ndesh me parimin kushtetues te hierarkise se normave, qe per rrjedhoje jane percaktuar se sipas nenit 116 "Aktet normative", kuptohet se cdo dispozite e meposhtme del ne baze dhe per zbatim te asaj me siper, qe do te thote aktet normative qe jane te renditura me afer bazes se piramides se Kelzen, rregullojne dhe shpjegojne ate cfare maja e piramides parashikon, por nuk mundet kurrsesi, qe nje norme me e vogel ne fuqine vertikale te saj, te krijoje norma te reja te cilat nuk jane te rregulluara me lart.*

*Konkretisht DST eshte nje dokument institucional qe del ne baze dhe per zbatim te ligjeve, qe do te thote nuk mundet Autoriteti Kontraktor me ane te DST te krijoje apo te ndryshoje ligjet, pasi fuqia juridike e DST mbetet vetem per fushen e veprimtarise qe ka dhe objektin qe rregullon. Detyrimi per te patur punonjesit e stafit mbeshtetes kontrate pune me akt noterial eshte pretendim i pabazuar ne ligj dhe i pashpjegueshem. Pamundesia apo frika e cdo subjekti te ligjit per shkelje te ligjit nuk justifikon mjetet joligjore te perdorura per realizimin e te drejtes. Ne kuader te parimit te proporcionalitetit te parashikuar ne nenin 17 te Kushtetues, thuhet se kufizimi i te drejtave duhet te justifikohet per shkakun te cilin behet dhe kjo vetem per interesa publike dhe me ligj. Ne rastin konkret nuk jemi para asnjerit kusht ligjor per te justifikuar ndryshimin e formes se kontrates se pones, per te cilen e ka mjaftueshem dispozita sqaruese dhe rregulluese te kesaj marredhenie juridike dhe nuk ka shkak pse te kete konfondim.*

*Ne nenin 14 specifikohet: 1. Me kontraten e punes me kohe te pjesshme, punemarresi pranon te punoje me ore, gjysme dite pune ose dite pune, per nje kohezgjatje normale javore ose mujore me te vogel se ajo e punemarresve qe punojne me kohe te plote ne te njejtat kushte. 2. Punemarresit me kohe pune te pjesshme gezojne te njejtat te drejta, si punemarresit me kohe te plote qe kryejne te njejten pune. Nese kushtet e punesimit kane lidhje te drejperdrejte me kohen e punes se punemarresit, punemarresi me kohe te pjesshme gezon te drejta perpjestimore me punemarresit me kohe te plote, perpjestimisht si punemarresi me kohe te plote pune. Mbeshtetur ne VKM nr. 914, date 29.12.2014 , i ndryshuar dhe LPP i ndryshuar, nuk specifikohet ne asnje nen asnje kriter ku ndalon konkurrimin e operatoreve ekonomike qe kane te punesuar me kohe te pjesshme disa nga punonjesit.*

*Ne keto kushte kerkojme modifikimin e ketij kriteri te vendosur ne kundershtim te hapur me kerkesat Ligjore qe parashtruam me lart, por edhe ne kundershtim te hapur me dispozitat ligjore. Per reference KPP 411/2020, date 02.10.2020.*

*Kerkojme te hiqet kerkesa per paraqitjen e kontratave noteriale te punes per punonjesit.*

*Fryma dhe qellimi i ligjit eshte te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit, te siguroje nje trajtim te barabarte te tyre ndaj, e ne funksion te kesaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet te jene pikerisht ne funksion te ketyre parimeve.*

*Se pesti kundershtojme piken Operatori te disponoje mjetet e meposhtme:*

| | | |
|---|---|---|
| *Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 3 -5 ton* | *copë 4* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobetoniere* | *copë 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobot uji* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik Prodhimi Asfalti* | *copë 1* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes mbi 20 ton* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Greider (me targa )* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 1.5-2 ton* | *Cope 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Rrul* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobitumatrice* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Nivelues betoni (helikopter)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |

| | | |
|---|---|---|
| *Minieskavator* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamion me vinc kapacitet mbajtes 6.5 - 8.5 ton* | *copë 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fadrom ( kove para dhe krahe mbrapa)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 10 - 12 ton* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Eskavator me goma (me targa)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autopompe betoni* | *cope 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik prodhim Inertesh* | *copë 1* | *Pronesi,Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Fabrik Prodhimi Betoni* | *copë 1* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Kantier ndertimi (zyre)* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik Prodhimi Fino* | *copë 1 (nje)* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Fabrik Prodhimi Koll* | *copë 1 (nje)* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Betoniere kantier* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *GPS* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Vinç karrel* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Rimorkiator  per levizjen e mjeteve* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Sistem Ëell Point* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Prerese pllakash* | *Cope 4* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Trapan* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Vibrator betoni* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Makineri vijezimi* | *Cope 1* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Matrapik* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Skeleri* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Rrjete mbrojtese* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Betonforma* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Pompe suvatimi* | *Cope 3* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Mjete mbrojtese* | | |
| *Kokore* | *110  Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fikse Zjarri* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Tabela Sigurimi Teknik* | *20 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Jelek* | *110 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kuti Ndihme e shpejt* | *10  Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Elemet sinjalistike* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Prozhektor per ndricim* | *2 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |

*Ne DST kerkohen nje numer shume i madh makinerish dhe pajisjesh te cilat jane shume te tepruara per nje volum te tille punimesh. Mbeshtetur ne analizen e punimeve te parashikuara nga ju ne preventiv dhe mbeshtetur ne Manualin e miratuar vkm nr.629 date 15/07 2015, perkatesisht ne kapitullin e makineri - pajisjeve inxhinieret tane arriten ne konkluzionin qe makinerite e kerkuara nga ana juaj jane te pajustifikuara dhe kerkojme te hiqen makinerit dhe pajisjet e teperta nga kerkesat per kualifikim dhe vendosjen e tyre ne perputhje me normat e shfrytezimit te makinerive ne analizat teknike te zerave te punes qe jepen ne VKM nr 629 date 12 15/07/2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" Me poshte sqarimi per mjetet e teperta:*

*Greider (me targa) cope 1*

*Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike cope 1*

*Kerkesa per Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike eshte e tepert per kete objekt, duke ditur qe kemi te bejme me rikonstruksion objekti dhe ku lartesia maksimale e objektit te prokurimit eshte 17 metra. Ky objekt mund te realizohet edhe me mjete vinc karel te cilat edhe Ak i ka kerkuar ne listen e disponueshmerise se mjeteve. Ky lloj autovinci qe ka kerkuar autoriteti kontraktor perdoret per montim trare urash, soleta urash ose per objekte me lartesi mbi 30m.*

*Per me teper ky lloj autovinci nuk gjendet ne Republiken e Shqiperise, por vetem ne Itali. Kerkojme heqjen e kerkeses per Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike.*

*Per grejderin kerkojme modifikimin qe ky mjet duhet te jete i patarguar. Per kete ju veme ne dispozicion vendimin: KPP eshte shprehur ne vendim:*

*"pikat 2, 3, 4 dhe 5 te nenit 113 i Ligjit Nr. 8378, date 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, parashikojne: "2. Per te qarkulluar ne rruge makinat teknologjike duhen regjistruar ne zyrat e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, qe i leshojne lejen e qarkullimit atij qe verteton se eshte pronari i mjetit;*

*3. Per te qarkulluar ne rruge makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike qe, per kerkeea funksionale, i tejkalojne permasat gabarite kufitare dhe peshat kufitare te percaktuara ne nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashte norme dhe per to zbatohen normal e parashikuara ne nenin 103, pika 8;4. Per te qarkulluar ne rruge makinat teknologjike vetelevizese dhe ato qe terhiqen, duhet te jene te pajisura me nje large njohjeje, e cila permban te dhenat e regjistrimit; 5. Menyrat e zbatimit te pikave 2 dhe 3, si dhe ato qe kane te bejne me modifikimet ne emertimin e mjeteve, permbajtjen dhe karakteristikat e lejes se qarkullimit, jane percaktuar me udhezime te organeve te Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit." Nga interepretimi literal i nenit te sipercituar, konstatohet qarte se per regjistrimin e mjeteve teknologjike ne zyrat e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor si dhe per pajisjen me targe njohje, leje qarkullimi dhe gjithe dokumentacionin lidhur me to, detyrimi ligjor lind vetem ne rastet kur mjetet teknologjike qarkullojne ne menyre vetelevizese ne rruge. Pra, ne asnje rast, legjislacioni ne fuqi per transportin rrugor ne Republiken e Shqiperise, nuk detyron pronaret e mjeteve teknologjike qe ti regjistrojne ato prane zyrave te Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, e per rrjedhoje te pajisen me targe njohje, leje qarkullimi etj, persa kohe ato transportohen me mjete te tjera dhe perdoren vetem ne kantier. Ne keto kushte, KPP gjykon*

*se operatori ekonomik ankimues e ka plotesuar kerkesen e autoritetit kontraktor ne drejtim te disponueshmerise se makinerive.*
*Se gjashti kundershtojme piken: Operatori ekonomikte kete Licence per Stacion Transfermi per mbetje jo te rrezikshme (stacionimin e dherave sipas germimit) Kodi III. I .A ne mbeshtje te vendimit te Keshillit te Ministrave VKM Nr. 419, Date 25/6/2014dhe Ligj Nr. 104448, Date 9/6/2011. Neni 1 i LPP parashikon shprehimish se: "Qellimi i ketij ligji eshte: a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore; b) te siguroje mireperdorim te fondeve pub like dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; 9) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik si dhe dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik. "Neni 4 i Ligjit nr. 10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit": "Ne perputhje me ligjin nr.10431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", krijohet nje sistem prej tri nivelesh te lejeve te mjedisit, te tipit A, B e C, si me poshte: a) leja e mjedisit e tipit A eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise A, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcen 1/A te ketij ligji; b) leja e mjedisit e tipit B eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise B, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcen 1/B te ketij ligji; c) leja e mjedisit e tipit C eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise C, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcen 1/C te ketij ligji". VKM nr. 538, date 26.5.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa", Aneksi 1 "Kategorite e licencave e lejeve qe si rregull trajtohen nga ose nepermjet QKL-se, Fusha III "Mjedisi dhe burimet mjedisore baze", Kategoria III.I "Per ndikimin ne mjedis": "1. Lejet mjedisore te percaktuara ne 34 pika 5 e ligjit nr. 8934, date 5.9.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, bejne pjese ne kategorine III.1 te shtojces se ligjit nr.10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" 11.2. Lejet e ndikimit ne mjedis ndahen ne tre nenkategori si vijon: a) "Leje e thjeshte mjedisore" me kodin III. I.A; b) "leje mjedisore" me kodin III.1.B; c) "leje e integruar mjedisore" me kodin III.1.C. "*
*Nga gjithe dispozitat e mesiperme konstatohet se: Objekti i prokurimit permban: Grumbullim, transport, depozitim, trajtim i mbetjeve qe perfshin ne vetvete edhe sherbimet e fshirjes dhe lajres se rrugeve. Pra, leja mjedisore per kete objekt qe leshohet nga QKL, eshte ajo me kodin III.I (A, B, ose C) dhe pershkrimi ne te i operacioneve te cilat mbulon eshte sipas emertimeve te percaktuara ne Shtojcen 1 "Lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi", te ligjit nr.10448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar, konkretisht ato te percaktuara ne kete Shtojce ne piken "Menaxhimi i mbetjeve", me nr. 5.1- 5.11. Nga dispozitat ligjore te sipercituara, ne referim te Shtojces 1 te ligjit nr.10448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar, rezulton qarte, se cilat jane aktivitetet qe pajisen me leje mjedisore (te tipit A, B, ose C) ne fushen e menaxhimit te mbetjeve. Ne kete kontekst, sipas Shtojces I te sipercituar, leja mjedisore sipas objektit te kontrates leshohen per aktivitetet ne pikat 5.3.(c), (d) ose (e) te Shtojces 1 te ligjit nr.10448, date 14.7.2011, me kod III.1.B ose III.1.C.*

*Lidhur me III.I.A tipi C eshte absolutisht e panevojshme per kete procedure. Ky kriter eshte abuzues nga ana juaj dhe tregon qe kriteret jane te paracaktuara. Sqarojme se mbetjet jo te rrezikshme te cilat dalin nga proceset e punes se rikonstruksionit ne objekte do te depozitohen ne grumbullimet e autorizuar ne qarkun ku ekzekutohet procedura dhe per kete lidhet marreveshje me firmen e cila merret me grumbullimin e tyre ne Bashkine e Elbasanit. Bashkia Elbasan e ka te percaktuar vendodhjen e grumbullimit te mbetjeve jo te rrezikshme. Per me teper Stacion trancferimi per mbetjet jo te rrezikshme me kodin III.I.A tipi C eshte vetem nje operator ekonomik ne qarkun tuaj. Pra ju e keni paracaktuar fituesin ?! Kerkesa e autoritetit kontraktor qe lejen mjedisore tip C, leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit per stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme (Kodi III. I .A), duhet ta disponoje vetem operatori ekonomik pjesemarres, eshte nje kerkese qe shkakton kufizim te panevojshem, pasi shume operatore ekonomik te cilet mund te disponojne te gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme per zbatimin me sukses te punimeve, penalizohen vetem per faktin qe nuk disponojne stacion transferimi mbetjesh. Ne keto kushte, me qellim hapjen e gares dhe zgjerimin e rrethit te pjesmarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 1, pika 2, te LPP i cili parashikon shprehimisht se: "2. Qellimi i ketij ligji eshte: a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; c;) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.*

*Kerkojme heqjen e ketij kriteri abuzues, diskriminues dhe kufizues i pjesemarrjes se lire te operatorev ekonomike eshte absolutisht i panevojshem.*

*Se shtati kundershtojme piken "HDPE, PVC, Korrogato dhe PE, plastike sipas preventivit, kontrata e tubove te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, katalogun, ISO 9001-2008, te dhenat teknike, makinerite e prodhimit te tubove, QKB, certifikata e cilesise se proves, KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi i plastikes).*

*Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi kur nuk eshte vete prodhues, per Pllaka, sipas preventivit, kontrata e tubave te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, certifikate ISO 9001:2015, makinerite e prodhimit dhe licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI III.1.A, Deklarate konfirmimi.*

*Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi kur nuk eshte vete prodhues, per Bar sipas preventivit, kontrata e barit te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, certifikate ISO 9001:2015, licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI II.4, Deklarate konfirmimi."*

*Ne kriterin sa me siper autoriteti kontraktor duhet te kerkoje qe per pajisjet e parashikuara ne preventiv qe do te vendosen ne veper, operatoret ekonomike te paraqesin autorizim prodhuesi ose distributori por duhet te heqe nga kriteri te gjithe elementet e tjere si certifikatat e prodhuesit si dhe specifikimet teknike te pajisjeve qe ne kete faze te procedures jane te tepruara dhe mbingarkojne se tepermi operatoret ekonomike per me teper eshte abuzive nga ana e autoritetit kontraktor kerkesa per "KODI III.I.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi*

*i plastikes, QKLKODI II.4 makinerite e prodhimit dhe licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI III.1.A, Deklarate konfirmimi.*
*licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI II.4, Deklarate konfirmimi"*
*Autoriteti kontraktor per mbarevajtjen e punes ka te drejte te kerkoje standarte mbi produktin autorizim prodhuesi/distributori zyrtar si dhe kataloge mbi keto produkte por jo te kerkoje dokumenta, [QKB, certifikata e cilesise se proves, KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi i plastikes)]. Mos paraqitja e ketyre QKL per riciklim plastikes dhe perpunimin e plastikes te prodhuesit nuk ndikon ne ekzekutimin me sukses te procedures.*
*Se teti kundershtojme piken: Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me te cilin prodhuesi/distributori autorizon kompanine pjesemarrese ne tender te ofertoje keto pajisje/mallra ne kete procedure prokurimi, si me poshte:*
*Pllaka*
*Pajisje elektrike*
*Polisterol*
*Hidroizoluese*
*Pajisje mekanike*
*Bojra hidroplastike*
*Pajisje hidraulike*
*Pasjisje hidrosanitare*
*Hekur*
*Kamera*
*Grafiato*
*Dyer dhe dritare*
*Referuar ne nenin 27 pika 1 te Vendimit nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar, parashikohet se: "1. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 23 te LPP dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara." [...]*
*Ne rastin konkret, gjykojme se specifikimet teknike jane hartuar ne menyre qe te drejtojne drejt nje produkti/mall/sherbim qe ofrohen nga nje operator i vetem ekonomik ose nga nje prodhues i vetem.*
*Kerkojme modifikimin e specifikimve teknike sipas projektpreventivit te percaktuar nga projektuesi. Fryma dhe qellimi i ligjit eshte te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit, te siguroje nje trajtim te barabarte te tyre ndaj, e ne funksion te kesaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet te jene pikerisht ne funksion te ketyre parimeve. Venia e ketyre kritereve eshte absolutisht diskriminuese dhe kufizuese per te gjithe operatoret e tjere te interesuar per te marre pjese ne gare dhe haptazi ne shkelje te LPP,VKM dhe rekomandimit nr 6732 prot date 21.10.2020 te APP.*
*Ju citojme si me poshte pika 6 e rekomandimit te APP:*

*Operatoret ekonomike ofertues ne nje procedure ne varesi te objektit mund te mos jene detyrimisht prodhues te mallit dhe e sigurojne mallin/sherbimin nga keta te fundit apo distributore te autorizuar prej tyre. Ne kete rast kerkesa per paraqitjen e certifikata te prodhuesit rezulton t'i adresohet paleve te treta (prodhuesit/distributorit) te cilat nuk jane konkurent/kandidat ne proceduren konkrete te prokurimit.*

*Ne kete rast APP rekomandon qe AK te vleresoje mundesine e kerkeses/pranimit te nje vetedeklarimi nga OE ofertues ne kete rast qe prodhuesi eshte konform sitemeve te kerkuara, dhe ne rastin kur OE shpallet fitues AK rezervon te drejten per te kerkuar paraqitjen e certifikatave ne fjale.*

*Ne analize te sa me siper, rezulton qartesisht e provuar se autoriteti kontraktues eshte organi pergjegjes per hartimin e dokumenteve te procedures konkuruese, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ai eshte pergjegjes, pervec hartimit te dokumenteve te procedures konkuruese, dhe per percaktimin e kerkesave per kualifikim, si dhe percaktimin e kritereve te vleresimit. Specifikimet teknike, projekt preventivat pergatiten nga struktura te specializuara per objektin qe do te kontraktohet brenda autoritetit kontraktues, apo edhe jashte tij kur kjo ekspertize mungon. Kjo per faktin se, ligjvenesi ne aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne mosmarreveshjen objekt shqyrtimi, ka percaktuar ne menyre te pergjithshme kushtet dhe kriteret ligjore qe duhet te permbushen per te pasur nje procedure konkuruese te ligjshme, duke percaktuar se te gjithe operatoret e interesuar per te marre pjese ne keto lloj prokurimesh, duhet te plotesojne keto kushte te cilat kane karakter ligjor, ekonomik-financiar dhe teknik. Ne gjykimin tone persa i perket detajimit te kushteve specifike, projekt preventivit, si dhe percaktimit te kritereve te pergjithshme, ligjvenesi ka ngarkuar per kete qellim autoritetin kontraktues qe organizon dhe zhvillon kete procedure konkurimi eshte edhe organi kompetent qe ka mundesi te plote teknike per ti detajuar keto kritere, ne perputhje me natyren e objektit qe po prokurohet. Per sa me siper, vleresojme se dokumentat standarte te procedures se prokurimit jane edhe aktet themelore mbi bazen e te ciles mund te zhvillohet procedura e prokurimit.*

*Kerkojme modifikimin e ketyre kritereve abuzuese, diskriminuese dhe kufizues i pjesemarrjes se lire te operatorev ekonomike. Ne asnje moment autoriteti kontraktor nuk duhet te percaktoje parametra teknike/ligjore kufizues e perjashtues, por duhet te percaktoje parametra minimale e maximale me qellim pjesemarrjen e nje numri sa me te larte te operatoreve ekonomike te interesuar. Autoritet kontraktore jane te detyruara te zbatojne me perpikmeri dispoziten e mesiperme te LPP-se ne hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe ne dokumentet e tenderit*

*Perseritja e gabimeve sipas pikave te sipershenuara qe ne kemi paraqitur ne kete ankese tregon se nuk behen aksidentalisht keto gabime pavaresisht impaktit te njejte qe japin ato ne zbatimin e ligjit qellimisht ose jo qellimisht. Nese nuk ndryshojne keto kritere brenda afatit ligjor te percaktuar me ligj jemi te detyruar qe pervec se te ndjekim rrugen ligjore ne KPP dhe te njoftojme APP per hetim administrativ te procedures, do t'i drejtohemi me shkrese te dedikuar Kontrollit te Larte te Shtetit KLSH qe te filloje proceduren e kontrollit qe nga momenti i shpalljes se kesaj procedure abuzive dhe korruptive nga ana e AK-se.*

*Si perfundim: Referuar shprehimisht Neni 1 i LPP parashikon shprehimish se "Qellimi i ketij ligji eshte: a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga*

*autoritetet kontraktore; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; f) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik si dhe dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik. "*
| 11 | 2.508 | F.V bolier 100 liter importi | cope | 4 | | |
| 11 | Punt | Montim pajisje | cope | 22 | | |
| 12 | Analiza | F.V Valvolmoskthimi DN40 (Ø 1½" ) me flanxha | cope | 2 | | |
| 13 | Analiza | F.V Galexhent mekanik DN50 (Ø 2" ) | cope | 1 | | |
| 14 | Material | F.V. Elemente plotsues per instalimet e linjave hidraulike (Niple, Manikota, Hollandez, Fije lini, Paste, Loctide leng, etj) | kompl | 1 | | |
| 15 | An - 19 | Pusete shkarkimi b/a, 80 x 80 cm, h = 100 cm | cope | 1 | | |
| | | **Shuma 1** | | | | |
| | 2 | **IMPJANTI I MBROJTJES NGA ZJARRI** | | | | |
| | | | | | | |
| 1 | 2.493/1 | F.V Tubacione celiku te zi DN 80 [2"], impjanti i mbrojtjes nga zjarri, ne perputhje me DIN 2440 ose DIn 2448, te mbrojtur nga jashte ndaj korrozionit, perfshire rakorderite, sistemin e mberthimit ne tavan ose te varura, materialet dhe punimet e bashkimit ose saldimit. Tub celiku pagel + rakorderi Ø2" X 3.65 mm | kg | 1500.00 | | |
| 2 | | **KARTELA SINJALIZIMI** | | | | |
| 3 | Analiza | F.V.Lidhje me motopompen (AL-5121-B ) | cope | 1.00 | | |
| 4 | Analiza | F.V Hidrant Zjarri - Kaseta (AL-5212-B ) | cope | 4.00 | | |
| 5 | Analiza | F.V Fiks Zjari me CO2 dhe Pluhur (AL- 5206 B ) ,(AL- 34A 233BC) | cope | 6.00 | | |
| | | **Shuma 2** | | | | |
| | 3 | **KANALIZIMI** | | | | |
| 1 | 2.520 | Tub kanalizimi pvc Ø 110 mm | ml | 20.00 | | |
| 2 | 2.519 | Tub kanalizimi pvc Ø 90 mm | ml | 15.00 | | |
| 3 | An | F.V Bryl 45º PP Ø110 | cope | 20.00 | | |
| 4 | An | F.V Bryl 45º PP Ø 50 | cope | 20.00 | | |
| 5 | An | F.V Bryl teknik 90º PP Ø110 per klozetat | cope | 4.00 | | |
| 6 | An | F.V Bryl 90º PP Ø 50 | cope | 20.00 | | |
| 7 | An | F.V Reduksione PP Ø 110-Ø 50 | cope | 10.00 | | |
| 8 | An | F.V Reduksione PP Ø 200-Ø110 | cope | 6.00 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 9 | An | F.V Brage PP DN 50/50 | cope | 10.00 | | |
| 10 | An | F.V Brage PP DN110/110 | cope | 10.00 | | |
| 11 | An | F.V Brage PP DN75/75 | cope | 10.00 | | |
| 12 | 2.515 | F.V Pilete shkarkimi dyshemeje me dopio sisifon me plluskim Ø 50 | cope | 4.00 | | |
| 13 | An | F.V Fasheta metalike me seksion rrethor dhe gomina elastomere per mberthimin e tubave Ø 110/75 | cope | 20.00 | | |
| 14 | An | F.V Pike pastrimi e inspektimi vertikale Ø 110 | cope | 2.00 | | |
| | | **Shuma 3** | | | | |
| | 4 | **NGROHJA ME KALDAJE** | | | | |
| 1 | An | F.V. Tubo celiku pa tegel, te lyer me dy duar boje kunder ndryshkut PN10bar 2" | m | 30.00 | | |
| 2 | An | F.V. Tubo celiku pa tegel, te lyer me dy duar boje kunder ndryshkut PN10bar 11/4" | m | 15.00 | | |
| 3 | An | F.V. Tubo plastike multishtresore te paraizoluar, T. Max 95ºC, PN10bar 1/2" D16 | m | 900.00 | | |
| 4 | An | F.V. Kunder vibrues gome i fllanxhuar PN10 21/2" | cope | 4.00 | | |
| 5 | An | F.V. Termoizolim gome me qeliza te mbyllura tip Armanflex 2"x19 mm | m | 30.00 | | |
| 6 | An | F.V. Termoizolim gome me qeliza te mbyllura tip Armanflex 11/4"x13 mm | m | 15.00 | | |
| 7 | An | F.V. Termometer radial DN 80 0-60ºC | cope | 2.00 | | |
| 8 | An | F.V. Termometer radial DN 80 0-120ºC | cope | 2.00 | | |
| 9 | An | F.V. Manometer radial DN 80 0-6 bar | cope | 2.00 | | |
| 10 | An | F.V. Grup furnizimi automatik 1" | cope | 1.00 | | |
| 11 | Material | F.V. Aksesore dhe suporte per fiksimin e tubove | kg | 100.00 | | |
| 12 | An | F.V. Kolektore dergim/kthim perngrohjen 11/4"( 10+10) | cope | 2.00 | | |
| 13 | An | F.V. Kolektore dergim/kthim perngrohjen 11/4"(7+7) | cope | 4.00 | | |
| 14 | An | F.V. Kolektore dergim/kthim perngrohjen 11/4"(9+9) | cope | 4.00 | | |
| 15 | An | F. V Elemente radiatorimeme flete alumini 600/200 | cope | 41.00 | | |
| 16 | An | F.V Reduksione bronxi Ø1 1/4-Ø3/8 | cope | 41.00 | | |
| 17 | An | F.V Valvol me buketon Ø1 1/4 dhe Ø11/2 | cope | 14.00 | | |
| 18 | An | F.V Ventila radiatori | cope | 41.00 | | |
| 19 | An | F.V Valvul radiatori | cope | 41.00 | | |
| 20 | An | F.V Detentore radiatori | cope | 41.00 | | |
| 21 | An | F.V Tapa radiatori | cope | 41.00 | | |
| 22 | An | F.V Mensola radiatori | cope | 82.00 | | |
| 23 | An | F.V.Saracineska kollone Ø1 1/4 dhe Ø2 | cope | 8.00 | | |
| 24 | Mat | F.V. Ene zgjerimi me membrane te kaldajae ngrohjes 150lt | cope | 1.00 | | |
| | | **Shuma 4** | | | | |
| | 5 | **SISTEMI I NGROHJES & FTOHJES** | | | | |
| 1 | Analize | F.V Tubo bakri me armaflex Ø 6.35mm | ml | 75 | | |
| 2 | Analize | F.V Tubo bakri me armaflex Ø 9.5 mm | ml | 75 | | |
| 3 | Analize | F.V Aksesor per montimin e tubacioneve te bakrit : fasheta, vida, dado, nastro aluminmi etj. | kompl | 1 | | |
| 4 | Analize | F.V Tubo PPR me rakorderi Ø 25 mm | ml | 40 | | |
| 5 | Analize | F.V Tubo PPR me rakorderi Ø 32 mm | ml | 10 | | |
| 6 | Analize | F.V Aksesor per montimin e tubacioneve PPR : fasheta, vida, dado etj. | kompl | 1 | | |
| 7 | Analize | Vendoje. Kondicioner Multi Split Mural, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.0 / 2.64 kW(9000BtU), prurja e ajrit mesatare Vaj.nom = 400 m³/h, fuqia elektrike 16 W, ushqimi 220-240V/1F/50Hz, lidhjet Gaz / Leng - Ø 9.5 mm / Ø6.35 mm, I kompletuar me te gjithe elemente e nevojshem per montim, termostat ambienti, kabull komunikimi me pajisjen e jashtme si dhe te gjithe aksesoret e nevojshem. | cope | 5 | | |
| 8 | Analize | Vendoje. KOMPRESOR I SISTEMIT "MultiSplit" VERSION POMPE NXEHTESIE - INVERTER<br>- Kapaciteti termik maksimal ne Ftohje: Q = 10.0 kW<br>- Kapaciteti termik maksimal ne Ngrohje: Q =12 kW<br>- Fuqija elektrike : 3.5 kW<br>- Lidhja Elektrike: 220V/1F/50HZ<br>- Kompresori model: Inverter<br>- Lidhjet e tubove Gaz: Ø 6.35 mm<br>- Lidhjet e tubove Leng: Ø 9.5/12.7 mm<br>I kompletuar me te gjithe elemente e nevojshem per montim. | kompl. | 1 | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Shuma 4 | | | | |
| | | SHUMA III | | | | |
| | | **SHUMA I-III** | | | | |
| | | **Fondi Rezerve 5%** | | | | |
| | | **Shuma PA TVSH** | | | | |
| | | **TVSH** | | | | |
| | | **SHUMA ME TVSH** | | | | |
| | | **PAJISJET** | | | | |
| F | | **FURNIZIM PAJISJE ELEKTRIKE** | | | | |
| F-1 | | **SISTEMI I DETEKTIMIT TËZJARRIT** | | | | |
| F-1.1 | analize | F. Central i alarmit te zjarrit, 1-loop tip inteligjent, i adresueshem, me regjistrim ngjarjesh, modul komunikimi, grafik karte, me porte kompjuterike, i programueshem, me bateri me 72 ore pavaresi, (Programim, testim dhe komisionim i sistemit te detektimit te zjarrit) | copë | 1 | | |
| F-1.2 | analize | F. Permutator telefonik me min tre numra | copë | 1 | | |
| F-1.3 | analize | F. Detektore tymi multi sensitiv, inteligjent te adresueshem, me modul komunikimi, me loop izolator te inkorporuar | copë | 43 | | |
| F-1.4 | analize | F. Detektore nxehtesie multi sensitiv inteligjent te adresueshem, me modul komunikimi, me loop izolator te inkorporuar | copë | 4 | | |
| F-1.5 | analize | F. Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te brendshem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 93dB. | copë | 3 | | |
| F-1.6 | analize | F. Sirena alarmi zjarri, me ndricues me llambe vezulluese, per vendosje ne ambient te jashtem, tip inteligjent te adresuesheme, me intesitet 120dB. | copë | 3 | | |
| F-1.7 | analize | F. Pulsant manual alarmi zjarri me thyerje xhami, me loop izolator te inkorporuar | copë | 10 | | |
| | | **Shuma F-1** | | | | |
| | | | | | | |
| **F-2** | | **SISTEMI I NDRICIMIT NORMAL, TE JASHTEM & EMERGJENCES** | | | | |
| F-2.1 | analize | F. Ndriçues katror panel inkaso LED, 27W, 60x60cm, IP40, 4000K, me difuzor opal, I kompletuar me te gjithe aksesoret e instalimit | copë | 16 | | |
| F-2.2 | analize | F. Ndriçues katror panel plafonier LED, 40W, 60x60cm, IP40, 4000K, me difuzor opal, i kompletuar me te gjithe aksesoret per instalim jashte murit | copë | 60 | | |
| F-2.3 | analize | F. Ndriçues katror plafonier LED, tip jashte murit 18W, IP20, 30x30cm, 4000K, me difuzor opal, i kompletuar me te gjithe aksesoret e instalimit | copë | 5 | | |
| F-2.4 | analize | F. Ndriçues plafonier LED, tip mural, 18W, IP65, Ø=220mm, 4000K, me difuzor opal, i kompletuar me te gjithe aksesoret e instalimit | copë | 8 | | |
| F-2.5 | analize | F. Ndriçues industrial LED per instalim jashte murit, 43W, L=1.2m, IP65, 4000K | copë | 5 | | |
| F-2.6 | analize | F. Ndricues Evakuimi 'Exit' me mbishkrimin Exit nga te dy anet per dergim dalje drejtim "Poshte/Majtas ose Djathtas", me set bateri te integruar, 3.5W, IP40 me autonomi 3ore | copë | 9 | | |
| F-2.7 | analize | F. Ndricues emergjence sigurie, rezistent ndaj zjarrit sipas standartit UNI EN 18-38 , IP 40, IK07, LED 8W, 230V, 50Hz, me bateri NiCd, 4.8V, 0.75h, 112lm,me autonomi ore | copë | 13 | | |
| | | **Shuma F-3** | | | | |
| | | | | | | |
| **F-3** | | **SISTEMI I DATA DHE TELEFONISË** | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| F-3.1 | analize | F. RACK Kompjuterik 19"42U, me dim. 600x600x1100mm, i kompletuar me te gjithe aksesoret, tip metalik, me dere xhami te armuar, me celes, drejtues te kabllove, me bllok te inkorporuar moduli ushqimi dhe ventilimim, me 1 grupe me nga 8 priza shuko 230V, 16A me tokezim | copë | 1 | | |
| F-3.2 | analize | F. Centrali Telefonie analog me 4 linja te jashtme dhe 12 numra te brendshem, me bateri, I kompletuar me te gjitha aksesoret e instalimit | copë | 1 | | |
| F-3.3 | analize | F. Patch Panel 24-porta RJ45 FTP Cat.6 (Interneti) | copë | 1 | | |
| F-3.4 | analize | F. Patch Panel me 24-porta RJ45 UTP Cat.6 (Telefonie) | copë | 1 | | |
| F-3.5 | analize | F. Gigabit Smart Switch me 24 porta RJ-45 (10/100/1000) Mb/s, 4 x SFP 1000 Mb/s, 4 x 1000BASE-X SFP, 104 Gb/s Routing/Switching Capacity, 128 MB SDRAM (Interneti) | copë | 1 | | |
| | | **Shuma F-4** | | | | |
| | | | | | | |
| **F-4** | | **SISTEMI CCTV** | | | | |
| F-4.1 | analize | F. 1. NVR (Network video Recorder), me 16kanare, FHD per menaxhimin e kamerave | copë | 1 | | |
| F-4.2 | analize | F. Kamera per ambient te jashtem, tip bullet, IP, POE, 4MPx, me lente varifokale te 2.8-9mm e motorizuar | copë | 5 | | |
| F-4.3 | analize | F. Kamera te brendshme, tip dome, IP, POE, 4MPx, me lente fikse 3.8mm | copë | 7 | | |
| F-4.4 | analize | F. HDD 4TB 3,5 inch. SAS 7200 rpm (15dite rregjistrime @ RAID6) ( i dizenjuar vecanerisht per Security, per te punuar 7dite ne Jave, 24 ore. Si edhe me jetegjatesi me te gjate se nje HDD i zakonshem kompjuteri ndaj ofron me shume garanci ne sherbim) | copë | 1 | | |
| F-4.5 | analize | F. Patch Panel 24-porta FTP Cat.6 (CCTV) | copë | 1 | | |
| F-4.6 | analize | F. Switch me 24 porta RJ-45, 100/1000 POE, 400W, me 2 porta fiber optike. Komplet me nderfaqesin e fibres te perfshire, FTP Cat 6 (CCTV) | copë | 1 | | |
| F-4.7 | analize | F. Monitor 32" LED Full HD, per monitorimin e sistemit te kamerave | copë | 1 | | |
| | | **Shuma F-4** | | | | |
| | | **Furnizimi me uje** | | | | |
| 1 | An | Pompa e sitemit te ujit sanitar teSpitalit me karakteristika teknike , singel pump me ene zgjerimi Lidhjet 2" PN 16 , Tensioni i dhene monofaze/ | cope | 1.00 | | |
| | | **Shuma** | | | | |
| | | **Pajisjet e impjantit MKZ** | | | | |
| 1 | An | **Grup pompimi MKZ**, per furnizimin e hidranteve me kasete, ne perputhje me normen UNI 9490 | cope | 1.00 | | |
| | | **Shuma** | | | | |
| | | **PAJISJET E DHOMES TEKNIKE TE KALDAJES** | | | | |
| 1 | An | Kaldaje celiku me lende djegese pelet me kapacitet termik Q=100kw | cope | 1.00 | | |
| 2 | An | Pompe binjake centrifugale prevalenca 7.5 m k H2O dhe , Q=12 mc/h , Per sistemin e ngrohjes se spitalit kaldaje -radiator . | cope | 1.00 | | |
| 3 | An | Ene zgjerimi per kaldajen me aseksore me karakteristika teknike: Autokllave me membrane . Presioni minimal / max 3/10 bar .Kapaciteti 150 litra . Diametri 500 mm dhe H=1080 mm .Lidhjet FØ 11/4 " | cope | 2.00 | | |
| 4 | An | Oxhak per kaldajen e ujit sanitar . Karakteristikat Teknike: Diametri Db 300 mm/Dj 400 mm . Llamarine inox . Termoizolim me lesh xhami me densitet te larte 5 cm , I kompletuar me fllanxha , elemente mbajtes, tirante celiku, kapoc(deflektor0 , vrime inspektimi te flakes dhe mbledhes kondensati | cope | 1.00 | | |
| | | **Shuma** | | | | |
| | | **2- FURNIZIM MAKINERI PAISJE SISTEMI I NGROHJES/FTOHJE** | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | *Pajisje dhe terminale të Sistemit HVAC Ngrohje/Ftohje* | | | | |
| 1 | | Furnizm. Kondicioner Multi Split Mural, kapaciteti ne ftohje / ngrohje 2.0 / 2.64 kW(9000BtU), prurja e ajrit mesatare Vaj.nom = 400 m³/h, fuqia elektrike 16 W, ushqimi 220-240V/1F/50Hz, lidhjet Gaz / Leng - Ø 9.5 mm / Ø6.35 mm, I kompletuar me te gjithe elemente e nevojshem per montim, termostat ambienti, kabull komunikimi me pajisjen e jashtme si dhe te gjithe aksesoret e nevojshem. | cope | 5 | | |
| 2 | | Furnizim. Kompreso i Sistemi "MultiSplit" Version Pompe Nxehtesie-Inverter<br>- Kapaciteti termik maksimal ne Ftohje: Q = 10.0 kW<br>- Kapaciteti termik maksimal ne Ngrohje: Q =12 kW<br>- Fuqija elektrike : 3.5 kW<br>- Lidhja Elektrike: 220V/1F/50HZ<br>- Kompresori model: Inverter<br>- Lidhjet e tubove Gaz: Ø 6.35 mm<br>- Lidhjet e tubove Leng: Ø 9.5/12.7 mm<br>I kompletuar me te gjithe elemente e nevojshem per montim. | kompl. | 1 | | |
| | | **SHUMA** | | | | |
| | | SHUMA E PAJISJEVE | | | | |
| | | **SHUMA TOTALE** | | | | |

III.1.3. Nëpërmjet shkresës nr. 70/12 prot., datë 22.12.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit si vijon:

*Sa i perket pretendimit mbi pikat e licences te kerkuara po ju bejme me dije se: Kategorite per punimet e ndertimit dhe niveli per cdo kategori punimesh zbatimi jane percaktuar referuar zerave te preventivit te punimeve per kete objekt si dhe ne mbeshtetje te plote te Vendimit te Keshillit te Ministrave Nr.42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", (i ndryshuar).*
*Per sa me siper pretendimi juaj nuk qendron.*

III.1.4. Fondi limit i procedurës së prokurimit është 25.000.000 lekë, pa TVSH.

III.1.5. Në VKM-në nr. 42, datë 16.01.2008 "Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi", Lidhja 4 "Klasifikimi paraprak i shoqërisë ndërtimore sipas nivelit për cdo kategori punimesh zbatimi" është përcaktuar niveli i punimeve të kryera për cdo kategori punimi si vijon:

**LIDHJA 4**
**KALSIFIKIMI PARAPRAK I SHOQËRIVE NDËRTIMORE SIPAS NIVELEVE PËR ÇDO KATEGORI PUNIMESH ZBATIMI**

| NIVELI I SHOQËRISË | SIPAS VLERAVE NË LEKË TË PUNIMEVE TË KRYERA PËR ÇDO KATEGORI PUNIMI |
|---|---|
| A (edhe për herë të parë) | 0- 20 milion lekë |
| B | 21- 50 milion lekë |
| C | 51 – 100 milion lekë |
| D | 101 – 200 milion lekë |
| E | 201 – 400 milion lekë |
| F | 401 – 800 milion lekë |
| G | mbi 800 milion lekë |

Në VKM nr. 42, datë 16.01.2008 "*Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi*", i ndryshuar, jepen shpjegimet për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme, ku përcaktohet:
*Lidhja 2*
*Kategorizimi sipas punimeve të zbatimit në ndërtim.*
*PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI*
*N.P –1 Punime gërmimi në tokë.*
*N.P –2Ndërtime civile dhe industriale.*
*N.P –3Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.*
*N.P –12Punime të inxhinierisë së mjedisit.*
*PUNIME SPECIALE NDËRTIMI*
*N.S-2 Impiante hidro-sanitare, kuzhina,lavanteri, mirëmbajtja e tyre.*
*N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).*
*N.S.-4Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.*
*N.S –8Ndërtime parafabrikat betonarme, struktura metalike dhe druri.*
*N.S –9 Punime strukturore speciale.*
*N.S –10Shtresa dhe mbistrukturaspeciale.*
*N.S -12Impiante teknologjik, termike dhe të kondicionimit.*
*N.S -13Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni.*
*N.S –14Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.*
*N.S –18Punime topogjeodezike.*
*N.S.-19 Sistemet kundër zhurmës për infrastrukturë*

*LIDHJA 3*
*Shpjegime për kategoritë e ndërtimeve (punimeve) të përgjithshme*

*N.P. 1 Punime gërmimi në tokëKonsiderohen gërmimet, sistemimet dhe ndryshimet në volum të tokës, të realizuara me çfarëdo lloj mjeti, pavarësisht nga natyra e terrenit që do të gërmohet ose sistemohet vegjetale, argjilore, ranore, zhavorrishteose shkëmbore.*

*N.P. 2 Ndërtime civile e industriale Konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta në objekte ku zhvillohen aktivitete njerëzore të drejtpërdrejtaose jo, kompletimi me strukturat e nevojshme dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje. Përfshin në mënyrë të thjeshtuar godina banimi, shkolla, zyra, kazerma ushtrie, teatro, stadiume, godina industriale, godina për parkim, burgje, stacione hekurudhore dhe metroje, godina aeroporti me ndonjë punim special në betonarme të thjeshtë ose të paranderur, betonim të tavaneve të hollë, membrana, kupola, depozita të varura, sillos dhe ndërtime të larta me strukturë me karakteristika të veçanta e komplekse.*

*N.P. 3 Rikonstruksion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasadashKonsiderohen zgjidhjet dhe koordinimi i punimeve të specialiteteve të nevojshme për riaftësim, konservim,*

*konsolidim, transformim, rivlerësim, ristrukturim. Konsiderohen gjithashtu dhe finitura të llojeve të ndryshme që lidhen me objektin, punime plotësuese dhe pajisje.*

*N.P. 12 Punime të inxhinierisë mjedisoreKonsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimit të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitet botanik dhe zoologjik.Përfshin në mënyrë të thjeshtuar procesin e riaftësimit natyror, botanik, faunistik, konservimin dhe riaftësimin e terrenit të përdorur për karriera e gurore, dhe të basenevehidrografike, eliminimine prishjes së ekuilibravehidrogjeologjik nëpërmjet kthimit në toka buke të veprave për stabilizimin e shpateve dhe ripyllëzimeve të punimeve të sistemimit bujqësor dhe të veprave për rivegjetizimin e skarpateve rrugore, hekurudhor të karrieravedhe mbetjeve inerte.*

*SHPJEGIME PËR KATEGORITË E NDËRTIMEVE (PUNIMEVE) SPECIALE*

*N.S-2 Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyreKonsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve hidrosanitare të kuzhinës, lavanterisë së gazit dhe kundër zjarrit, sado që të jetë shkalla e rëndësisë së veprave, e kompletuar me punimet e muraturës plotësuese ose ndihmëse, që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

*N.S-3 Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)Konsiderohet, montimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i impianteve transportuese, ashensorë, shkallë të lëvizshme, ngritëse dhe të transportit, komplet dhe të lidhur me çdo punim murature plotësuese ose ndihmëse që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

*N.S-4 Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtueseKonsiderohet ndërtimi, mirëmbajtje ose ristrukturim i muraturës dhe mureve ndarës të çfarëdo lloji, tipi, përfshirë suvatimin, patinimin, bojatisjen dhe punime të ngjashme me to.Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i karpenterisë dhe punimeve prej druri, të dyerve dhe dritareve të brendshme dhe të jashtme, të veshjeve të brendshme dhe të jashtmetë dyshemeve të tipeve të ndryshme dhe me materiale të ndryshme dhe të punimeve të realizuara me dorë, me metal, dru, material plastik dhe material xhami ose të ngjashëm.Konsiderohet vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i izolimit termik dhe akustik, nënçatitë dhe mbrojtja nga zjarri, izolimi i natyrave të ndryshme dhe me materiale të ndryshme.*

*N.S –8 Ndërtime parafabrikat me beton të armuar, struktura metalike dhe druriPërfshin prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vepër të strukturave*

*parafabrikate prej betoni të armuar, normal dhe të paranderur.Prodhimin nëkantierdhe montimin në vepër të strukturave prej çeliku ose të fasadave të përbëra nga telajo metalike dhe elemente modulare prej xhami ose materiali tjetër.Prodhimin në rrugë industriale dhe montimin në vend të strukturave të përbëra nga elementë të drejtë të trajtuar përpara.*

*N.S-9 Punime strukturore specialeKonsiderohet ndërtimi i objektit i destinuar për transmetimngarkese të realizuar në terrene jo të përshtatshme për mbajtjen e këtyre ngarkesave,*

*të objekteve të destinuara për t'u ndërtuar në terrene rezistontedhe jo të deformueshme, por me parashikime të lëvizjeve gjeologjike, të objekteve me karakter antisizmik të strukturave ekzistuese.Përfshin në mënyrë të thjeshtuar zbatimin e pilotëvetë çfarëdolloj tipi, të themeleve nëntokësore me pilotëose me mure mbajtëse, me ankorim, të objekteve që duhet të rivlerësohen nga funksioni statik i strukturës, me zbatim të punimeve nëntokësore me mjete speciale, përshirë edhe marrjen e kampioneve për analiza laboratori nga pikëpamja gjeoteknike, gjithashtu të provave me ngarkesë, të sondave të veprave që sigurojnë qëndrueshmërinë e shpateve. Impermeabilizzazione dhe konsolidimin e terreneve.*

*N.S-10 Shtresa dhe mbistruktura specialeKonsiderohet ndërtimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i shtresave (dyshemeve) të realizuara me materiale të veçanta, natyrale ose artificiale, të cilat janë me ngarkesa të konsiderueshme, si mund të jenë pistat aeroportuale.*

*N.S -12 Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimitKonsiderohen montimi dhe mirëmbajtje ose ristrukturimi i njësistemi të plotë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të ngrohjes, ventilimit dhe kondicionimit të klimës, të impianteve pneumatike, të kompletuara me punimet murature, plotësuese ose ndihmëse, për të realizuar bashkimet ose ndërhyrjet që i përkasin kategorive të përgjithshme që janë realizuar ose janë në proces realizimi.*

*N.S -13 Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioniKonsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimi i linjave telefonike të jashtme dhe impiante të telekomunikacionitme frekuencë të lartë, sido që të jetë shkalla e rëndësisë së tyre, të kompletuara me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për tu realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janë realizuar ose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

*N.S-14 Impiante të brendshme elektrike, telefonike, radiotelefoni TV Konsiderohet montimi, mirëmbajtja dhe ristrukturimii linjave elektrike, telefonike, radiotelefoni e TV, si edhe të linjave të transmetimittë ngjashme me to, të kompletuar me çdo punim të lidhur me muraturën, plotësuese ose ndihmëse, për t'u realizuar, të ndara nga zbatimi i sistemeve të tjera që janërealizuarose janë duke u realizuar në punimet e përgjithshme.*

*N.S -18 Punime topogjeodezikeKonsiderohet zbatimi i rilevimeve topografike speciale që kërkojnë mjete dhe organizim të veçantë, punime topogjeodezike në objekte inxhinierike, punime speciale gjeodezike; rrjeta mbështetëse dhe qëndrueshmëri terrenesh.*

*N.S -19 Sistemi i mbrojtjesnga zhurmat në infrastrukturëKonsiderohet ndërtimi dhe vendosja në vepër, mirëmbajtja dhe verifikimi akustik i objektit për zhurmën me origjinë rrugore, hekurudhore, të barrierave metalike betonarme, dru xham, ose material plastik transparent, të mureve dopio, të mureve poroze ose të tullave poroze, gjithashtu edhe të veshjeve zëizoluese të pareteve të terrenit ose të tuneleve.*

III.1.5. Në nenin 1 "*Objekti dhe Qëllimi*" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, parashikohet se:

1. *Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore.*
2. *Qëllimi i këtij ligji është:*

*a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore;*
*b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
*c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
*ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
*d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
*dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

III.1.6. Në nenin 20 "*Mosdiskriminimi*" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik",* i ndryshuar, thuhet:

*"Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre".*

III.1.7. Në nenin 46, pika 1 gërma gërma "a" e ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, përcakton:

*"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:*
*a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;"*

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjestim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit.
Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura, për realizimin e sukses të kontratës me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1 pika 2 të LPP-së.

Në rastin konkret, referuar fondit limit dhe preventivit të procedurës së mësipërme të prokurimit, Komisioni gjykon se kriteri i autoritetit kontraktor përsa i përket nivelit të kategorive të liçencave të kërkuara, nuk është në përputhje me përmasat e objektit që prokurohet. Këto nivele nuk janë në përputhje me vlerën në lekë të punimeve që do të kryen, duke marrë në konsideratë shumën e minimumeve të mundshme të punimeve të përgjithshme dhe punimeve special. Duke konsideruar se niveli A i shoqërisë duhet të ketë kryer vlera në lekë të punimeve për cdo kategori nga 0-20 milion lekë dhe niveli B duhet te ketë kryer punime për cdo kategori në vlerën 21-50 milion lekë ndërkohë që fondi limit i procedurës së prokurimit është 25 milion lekë pa tvsh, nuk justifikohet kërkesa e AK përsa i përket nivelit B të kategorive të parashikuara.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: "*Se dyti kundershtojme piken: Per te provuar se ka pervoje e duhur, Operatori duhet te deshmoje se ka te punesuar mesatarisht te pakten 110 (njqind e dhjete) punonjes, me kohe te plote, per periudhen Janar 2020 - Tetor 2020 te deshmuar me;*
*a. Vertetim te leshuar nga Administrata Tatimore, ku te specifikohet numri i punonjesve per secilin muaj ne periudhen e mesiperme.*
*b. List pagesat e punonjesve te plotesuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per secilin nga muajt ne periudhen e mesiperme.*
*Autoriteti kontraktor hartimin e kritereve duhet ta beje ne menyre gjitheperfshirese duke krijuar kushte per konkurrim te paanshem e te hapur ndermjet te gjithe kandidateve e ofertuesve. Nje nder parimet kryesore te zhvillimit te procedures jane ato te transparences dhe trajtimit te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike.*
*Theksojme kriteri per fuqine punetore i sherben autoritetit kontraktor per te provuar vetem kapacitetet teknike dhe profesionale te operatorit ekonomik, qe vleresohen te nevojshme per te realizuar kontraten qe prokurohet. Ky kriter nuk eshte pjese e kritere qe vertetojne eksperienca te suksesshme ne realizimin e punimeve dhe duke iu permbajtur edhe te rekomandimit nr 6732 prot date 21.10.2020 te APP ne kete rast autoriteti kontraktor jo vetem qe nuk ka hartuar analize teknike te numrit te puntorise ne raport me punimet dhe afatin e realizimit te tyre por qartazi dhe haptazi ka injoruar dhe s'ka marre fare parasysh respektimin e LPP dhe VKM nr 914. Ne vleresimin tone kerkesa e AK per fuqine punetore duhet te behet ne funksion te qellimit per te cilin kerkohet (per realizimin e objektit konkret te prokurimit". […]*
*Gjykojme se e rendesishme per autoritetin kontraktor eshte qe te vertetohet disponimi i punonjesve ne momentin e zhvillimit te procedures se prokurimit dhe periudhen e zbatimit te punimeve sipas kontrates objekt prokurimi. Per aq kohe sa vertetohet se ata jane te punesuar prane operatorit ekonomik ne perputhje me parashikimet e Kodit te Punes se Republikes se Shqiperise, si dhe figurojne ne listepagesa ne perputhje me legjislacionin, cili eshte motivi qe autoriteti kontraktor kerkon qe keta punonjes te jene me kohe te plote pune?*
*Ne piken 5, te nenit 26, te VKM nr.914, date 29.12.2014 parashikohet qe cdo kriter i vecante duhet te jete ne perputhje me natyren dhe permasen e kontrates. Marre shkas nga tipologjia e objektit te kontrates qe prokurohet, punimet konkrete te parashikuara dhe volumet e tyre, gjykojme se AK*

*duhet te rishikoje kete kerkese pasi eshte diskriminuese dhe kufizuese per operatoret ekonomik te interesuar per te marre pjese ne kete procedure prokurimi.*
*Kerkojme uljen e numrit te punonjesve ne 52 punonjes dhe heqjen e kerkeses qe keta punonjes te jene me kohe te plote sipas vendimit te KPP vendimi nr 322/2019 date 28.05.2019",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 3, gërma "a" dhe "b", nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

1. ***<u>Deshmi per fuqine mesatare punetore te operatorit ekonomik:</u>***

***Per te provuar se ka pervoje e duhur , Operatori duhet te deshmoje se ka te punesuar** mesatarisht të paktën **110 (njqind e dhjete)** punonjes, me kohe te plote, për periudhën **Janar 2020 - Tetor 2020** të deshmuar me;*

***a.*** *Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj ne periudhen e mesiperme **.***

***b.*** *List pagesat e punonjesve te plotesuar rregullisht sipas formatit e percaktimeve qe kerkohet nga legjislacioni ne fuqi per secilin nga muajt ne periudhen e mesiperme.*

III.2.2. Nëpërmjet shkresës nr. 70/12 prot., datë 22.12.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit si vijon: *"Sa i perket pretendimit mbi punonjesit dhe stafit te kerkuar te operatorit ekonomik, ju bejme me dije se: Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqerise eshte kerkuar deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik te nevojshem per realizimin e kontrates ne mbeshtetje te germes (b), pika 8 e Nenit 26, Seksioni II, Kreu III te VKM Nr.914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik (i ndryshuar), si dhe ne mbeshtetje te Ligjit Nr.9643, date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", Neni 46, pika 1, germa ( b ). Numri i punonjesve eshte percaktuar referuar volumeve te punes qe do te kryhen, afatit te realizimit te kontrates objekt prokurimi si dhe grafikut te punimeve te percaktuar nga autoriteti kontraktor me qellim realizimin me sukses te kontrates. Eshte vendosur ky numer punonjesish, referuar zerave te punes qe do te kryhen sipas preventivit dhe si dhe afatit te perfundimit te punimeve te parashikuar si dhe referuar VKMNr. 629, date 15.07.2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre". Jane mbledhur te gjithe oret e punes te puntorise per te gjithe zerat e punimeve, duke percaktuar specifikisht numrin e punonjesve. Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale te shoqerise eshte kerkuar personeli i nevojshem inxhinierik referuar zerave te preventivit te objektit per realizimin e kontrates ne mbeshtetje te germes "b", te pikes 1 te nenit 46 te Ligjit 9643, date 20.11.2006, per "Prokurimin publik", i ndryshuar, ku percaktohet se: "operatoret ekonomike duhet te vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale ... si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten .... " si dhe te nenit 44 pika 1 e Ligjit Nr 9643 per "Prokurimin Publik" ku percaktohet se: "Ne rastet e kontratave publike per sherbime apo pune si dhe te kontratave publike te furnizimit per sherbime shtese dhe/ose veprimtari instalimi Autoritetet Kontraktore mund t'u kerkojne personave juridike te paraqesin ne oferte ose ne kerkesen per pjesemarrje emrat dhe kualifikimet profesionale perkatese te personelit pergjegjes per zbatimin e kontrates ne fjale".*

*Referuar preventivit te punimeve te zbatimit i cili u eshte vene ne dispozicion ne platformen elektronike te Agjensise se Prokurimit Publik eshte parashikuar se do te kryhen punime rikonstruksioni godine punime kondiconimi, impiante shuarje zjarri, rifinitura, punime ndertimi, istalimi, sisteme rrjeti, sisteme ndricimi etj dhe per kete eshte i domosdoshem prania e stafit te kerkuar ne objekt. Dokumentacioni plotesues i kerkuar ne kriteret e vecanta per kualifikim pjese perberese e dokumentave te tenderit, sikunder jane, kontrate pune e vlefshme, apo qenesia e tyre ne listpagesat e shoqerise, jane vendosur per arsye se me paraqitjen e ketij dokumentacioni vertetohet se keta drejtues teknike jane operative prane Ofertuesve te mundshem dhe ne kete menyre Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatoret ekonomike pjesemarres zoterojne personelin e nevojshem per realizimin me sukses te objektit qe prokurohet. Se pari kjo kerkese mbeshtetet ne Ligjin Nr.9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin Publik" (i ndryshuar), Neni 44 ku citohet se: "Ne rastet e kontratave publike per sherbime apo pune, si dhe te kontratave publike te fumizimit per sherbime shtese dhe/ose veprimtari instalimi, autoritetet kontraktore mund t'u kerkojne personave juridike te paraqesin nje oferte ose ne kerkesen per pjesemarrje emrat dhe kualifikimet profesionale perkatese te personelit pergjegjes per zbatimin e kontrates ne fjale, Neni 46, pika 1, germa "b" ku citohet se: "aftesia teknike: operatoret ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten, sic eshte pershkruar nga autoriteti kontraktor ne njoftimin e objektit te kontrates" si dhe ne VKM Nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik" (e ndryshuar), Neni 26, pika 8, germa "b" ku citohet se: "deshmi per fuqine punetore te operatorit ekonomik, te nevojshem per ekzekutimin e objektit te prokurimit, dhe/ ose .... "*

*Se dyti, numri mesatar i punonjesve, eshte caktuar ne baze te llogaritjeve te zerave te punes dhe volumit perkates te cdo zeri ne preventivat e zbatimit te punimeve si dhe grafikut ne zbatimit te punimeve. Nepermjet ketij kriteri kerkohet qe te vertetohet se operatoret ekonomike zoterojne kapacitetet e nevojshme lidhur me stafin qe kane ne dispozicion, qe kane qendrueshmeri te stafit pa shkeputje nga puna, deshmi te cilat i japin garancite e nevojshme autoritetit kontraktor ne funksion te qellimit per te cilin prokurohet pra qe operatori ekonomik ka aftesi per realizimin e kontrates.*

III.2.3.Në nenin 20 "*Mosdiskriminimi*" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar parashikohet se:

*"Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre".*

III.2.4. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" dhe gërma "b" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar parashikohet se:

"*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme,*

*për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".*

Neni 53/3 të LPP-së përcaktohet se:

*"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlereson një ofertë të vlefshme, vetem nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe ne dokumentat e tenderit".*

III.2.5. Në nenin 27/3 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", përcaktohet se:

"*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".*

III.2.6. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë: Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:
*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë"*

III.2.7. Në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punës, Kreu V, neni 12, specifikohet:
*Kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim. Lejohet lidhja e kontratave ndërmjet punëdhënësit dhe punëmarrësit me kohë të pjesshme dhe ky i fundit gëzon të njëjtat të drejta si punëmarrësit me kohë të plotë.*

Në nenin 14, po këtu, specifikohet: *1. Me kontratën e punës me kohë të pjesshme, punëmarrësi pranon të punojë me orë, gjysmë dite pune ose ditë pune, për një kohëzgjatje normale javore ose mujore më të vogël se ajo e punëmarrësve që punojnë me kohë të plotë në të njëjtat kushte. 2. Punëmarrësit me kohë pune të pjesshme gëzojnë të njëjtat të drejta, si punëmarrësit me kohë të plotë që kryejnë të njëjtën punë. Nëse kushtet e punësimit kanë lidhje të drejpërdrejtë me kohën*

*e punës së punëmarrësit, punëmarrësi me kohë të pjesshme gëzon të drejta përpjestimore me punëmarrësit me kohë të plotë, përpjesëtimisht si punëmarrësi me kohë të plotë pune.*

III.2.8. Referuar sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Komisioni vlereson se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përputhje me objektin e prokurimit, natyrën, aftësinë zbatuese, vlerën si dhe përmasat/volumin e kontratës. Në këtë kontekst kërkesa e autoritetit kontraktor për punonjës me kohë të plotë, sic është parashikuar në kriteret e kualifikimit, tejkalon natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet.

Pretendimi i ankimuesit qëndron.

III.2.9. Gjithashtu, referuar kriterit për vërtetimin e disponimit të kapacitetit të ofertuesit për jo më pak se 110 punonjës, Komisioni vlerëson se autoriteti kontraktor ka tejkaluar natyrën dhe përmasat e kontratës, pasi një numër i tillë punonjësish është joproporcional me objektin e prokurimit. Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj. Komisioni vlerëson se kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka kufizuar konkurencën ndërmjet operatorëve ekonomikë.
Në këtë kuptim Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin sa më sipër duke përcaktuar një numër të arsyeshëm dhe proporcional me përmasat e kontartës që do të prokurohet me qëllim zgjerimin e rrethit të pjesmarrjes së operatorëve ekonomikë në respekt të nenit 1, pika 2, të LPP i cili parashikon shprehimisht se: 2. Qëllimi i këtij ligji është: *a) të rrisë efiçencën dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik, të kryera nga autoritetet kontraktore; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*
Për autoritetin kontraktor është e nevojshme dhe e mjaftueshme që operatorët ekonomikë të plotësojnë të gjitha kapacitetet ekonomike, teknike, profesionale për realizimin me sukses të kontratës, duke evituar kushte kufizuese sikundër në rastin konkret, pasi një kriter i tillë nuk i shërben qëllimit për realizimin me sukses të kontratës, por krijon efektin e kufizimit për pjesmarrjen e gjërë të operatorëve ekonomikë. Dokumentat e tenderit dhe kriteret për kualifikim duhet të hartohen në përputhje me LPP-në dhe rregullat e prokurimit publik në mënyrë të tillë që të nxisin pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë, të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm, si dhe të sigurojnë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në këto procedura.

Për autoritetin kontraktor e rëndësishme të provohet disponimi i punonjësve, por kjo duhet të përcaktohet në mënyrë të arsyeshme duke pasur parasysh elementë të tillë si natyra e kontratës dhe volumi i saj. Komisioni vlerëson se, kriteri i sipërcituar nuk është hartuar tërësisht në përputhje me frymën e legjislacionit të prokurimit publik, pasi ka kufizuar konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë, duke përfshirë në të vetëm ata operatorë të cilët plotësojnë numrin e kërkuar prej 110 punonjësish, si dhe duke përjashtuar kështu operatorë të tjerë ekonomikë të cilët edhe pse mund të garantojnë zbatimin e kontratës, si dhe mund të përmbushin të gjitha kriteret kualifikuese për këtë procedurë prokurimi, do të penalizohen vetëm për faktin se nuk përmbushin numrin e kërkuar të punonjësve, i cili në rastin konkret është i ekzagjeruar. Sa më sipër, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm, duke ulur numrin e punonjësve dhe duke përcaktuar një numër minimal të arsyeshëm dhe proporcional me volumin dhe përmasat e objektit të prokurimit, të nevojshme për realizimin e kontratës.

Për sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues për numrin e punonjësve qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: "*Se treti kundershtojme piken Pjese e stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise:*
*Inxhinier Ndertimi 2 (dy)*
*Inxhinier Elektronik 1 (nje)*
*Inxhinier Mjedisi 1 (nje)*
*Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)*
*Inxhinier Gjeodet 1 (nje)*
*Inxhinier Elektrik 2 (nje)*
*Inxhinier Mekanik 1 (nje)*
*Arkitekt 2 (dy)*
*Secili prej pjestareve te drejtuesve teknik te mesiperm, duhet te jete ne Listepagesat te pakten per periudhen Janar 2020 - Tetor 2020 si dhe te figurojne ne licensen e shoqerise.*
*Per secilin prej pjesetareve te stafit duhet te paraqitet:*
*- kontrate noteriale pune e vlefshme- diploma*
*Referuar tipologjise se objektit qe do te prokurohet, punimeve te percaktuara ne preventiv, veprimtarise konkrete te punimeve e cila eshte e perqendruar ne nje kantier te vetem, per cfare arsye e mbi c'analize teknike autoriteti kontraktor ka kerkuar Inxhinier Ndertimi 2 (dy), Arkitekt 2 (dy), Inxhinier Elektrik 2nje)*
*Autoriteti kontraktor eshte ne shkelje te hapur me nenin 26 pika 5 VKM nr 914 date 29.12.2014, ku parashikohet qe" ... kriteret duhet te jene ne perpjestim dhe te lidhura ngushte me aftesise zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates". Konstojme se kriteri i mesiperm nuk eshte ne perputhje dhe proporcion me natyren dhe volumin e kontrates dhe si nje kriter i tille duhet ndryshuar. Per me teper kemi te bejme me nje kantier te vetem ne lidhje me diponueshmerine e dy inxhinierve ndertimi drejtues teknik, 2 inxhiniere elektrik, 2 arkitekt, gjykojme se ne hartimin e kritereve te vecanta te kualifikimit, ne respekt te nenit 46 pika 1 te ligjit nr.9643 date 20.11.2006 "Per prokurimin publik" te ndryshuar autoriteti kontraktor duhet te parashikoje kritere kualifikuese ne perputhje me natyren dhe volumin e kontrates. AK si parakusht sine qua non per*

*hartimin dhe vendosjen e kritereve te vecanta te kualifikimit duhet qe keto te fundit ti hartoje ne perputhje me natyren e kontrates dhe volumin e punimve. Sa me siper, referuar natyres se kontrates, volumit te kryerjes se punimeve, llojit te punimeve te kerkuar, si edhe kategorizimit te pikave te licences, nuk shfaqet e nevojshme disponueshmeria e 2 inxhiniere ndertimi, 2 inxhiniere elektrik, 2 arkitekt si pjese e stafit teknik.*
*Ky kriter eshte qartazi dhe haptazi i hartuar qellimisht ne menyre abuzive dhe ne shkelje te ligjit vetem per te realizuar kufizimin e pjesemarrjes se operatoreve ekonomike te interesuar pasi objekti qe prokurohet eshte nje objekt i vetem.*
*Kerkojme modifikimin e ketij kriteri dhe inxhinieret e mesiperm te kerkohen si staf mbeshtetes.*
*BEHET:*
*Pjese e stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise:*
*Inxhinier Ndertimi 1 (nje)*
*Inxhinier Elektronik 1 (nje)*
*Inxhinier Mjedisi 1 (nje)*
*Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)*
*Inxhinier Gjeodet 1 (nje)*
*Inxhinier Elektrik 1 (nje)*
*Inxhinier Mekanik 1 (nje)*
*Arkitekt 1 (nje)*
*Secili prej pjestareve te drejtuesve teknik te mesiperm, duhet te jete ne Listepagesat te pakten per periudhen Janar 2020 - Tetor 2020 si dhe te figurojne ne licensen e shoqerise.*
*Per secilin prej pjesetareve te stafit duhet te paraqitet:*
*- kontrate noteriale pune e vlefshme*
*- diploma",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.3.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 3, gërma "c", nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:
*Pjese e stafit te shoqerise dhe te figuroje ne Licensen e kompanise:*

*Inxhinier Ndertimi 2 (dy)*
*Inxhinier Elektronik 1 (nje)*
*Inxhinier Mjedisi 1 (nje)*
*Inxhinier Hidroteknik 1 (nje)*
*Inxhinier Gjeodet 1 (nje)*
*Inxhinier Elektrik 2 (nje)*
*Inxhinier Mekanik 1 (nje)*
*Arkitekt 2 (dy)*

*Secili prej pjestarëve të drejtuesve teknik të mësipërm, duhet te jetë ne* ***Listëpagesat te pakten per periudhen Janar 2020 - Tetor 2020 si*** *dhe te figurojne në* ***licensën e shoqërisë****.*
*Per secilin prej pjesëtareve të stafit duhet tëparaqitet:*
***- kontratë noteriale pune e vlefshme- diploma***

III.3.2. Në nenin 20 "Mosdiskriminimi" të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar parashikohet se:

*"Autoritetet kontraktore duhet të shmangin çdo kriter, kërkesë apo procedurë, që lidhet me kualifikimin e operatorëve ekonomikë, që përbën diskriminim ndaj ose midis furnizuesve apo kontraktorëve ose ndaj kategorive të tyre".*

III.3.3. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" dhe gërma "b" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"* i ndryshuar parashikohet se:

*"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës".*

Neni 53/3 të LPP-së përcaktohet:

*"Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlereson një ofertë të vlefshme, vetem nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe ne dokumentat e tenderit".*

III.3.4. Në nenin 26/5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", përcaktohet se:

"*Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 46 të LPP. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve".*

III.3.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 26, pika 8, parashikohet si më poshtë:

*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*
*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratë"*

III.3.6. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor harton dokumentat e tenderit, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kritereve të veçanta për kualifikim

është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktues, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën e kontratës së prokurimit. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Në rastin konkret, lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues mbi kërkesën e autoritetit kontraktor për *2 inxhiniere ndertimi, 2 inxhiniere elektrik, 2 arkitekt si pjese e stafit teknik,* referuar objektit të prokurimit, preventivit dhe informacionit të autoritetit kontraktor rezulton se këto kërkesa nuk janë në përputhje me volumin e kontratës, ndaj autoriteti kontrator duhet të marrë masa për uljen e numrit të tyre.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: "*Se katerti kundershtojme piken: e. Krahas stafit te mesiperm te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*
*- Inxhinier Ndertimi projili strukturist-1;*
*- Inxhinier Telekomunikacion - 1;*
*-Teknik Gjeometer -1;*
*-Teknik Hidroteknike - 1*
*-Teknik ndertimi - 3;*
*-Teknik Topograf-1;*
*-Teknik Mekanik -3;*
*- Agranom -1;*
*- Hekurkthyes -1;*
*- Hidraulik -2;*
*-Murator- 2*
*-Suvatues - 2*
*-Specialist kamerash -2*
*-Specialist lT - 2*
*-Ndertimtari -1*
*- Elektricist -2;*
*- Bojaxhi -1;*
*- Karpentier -2;*
*- Pllakashtrues -1;*
*- Specialist per ndihmen e pare -1;*
*- Specialist Saldator -4*
*-Specialist Sistem Ngrohje Ftohje -1*
*-Automakinist - 2;*
*-Shofer - 4;*
*- Eskavatorist me goma dhe zinxhir/Manovrator - 5;*
*Operatori ekonomik te paraqes per stafin e mesiperm kontratat noteriale te punes, diplome dhe ose kualifikimin perkates per secilin punonjes. Deshmia e kualifikimit dhe/ose diploma te jete e leshuar nga institucione te licensuara shteterore Arsimore Profesionale. Stafi i mesiperm te*

*figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht muajt e fundit (Shtator 2020-Tetor 2020-Nentor 2020).*

** Mos paraqitja e kontrave te nenshkruara perpara noterit mes paleve kontratore do te jete kusht skualifikues.*

** Ne rastin e paraqitjes se kontratave kolektive detyrimisht te jene konform nenit 160 te Kodit te Punes sipas parashikimeve ligjore ne fuqi.*

*Dhe nje here ju veme ne dukje qe duhet ti permbaheni frymes dhe parimeve ligjore. Pikes 5 te nenit 26 te VKM nr. 914, date 29.12.2014 ku parashikohet se:" ... Kriteret duhet te jene ne perpjesetim dhe te lidhura ngushte me aftesine zbatuese, natyren dhe vleren e kontrates." Ky kriter i vendosur nga ana e autoritetit kontraktor qe nuk eshte ne perpjestim dhe i lidhur ngushte me objektin qe prokurohet kerkojme te saktesoni numrin e kerkuar per punonjesin teknik gjeometer. Per reference vendimi nr 322/2019 date 28.05.2019 KPP.*

*Mbeshtetur ne ligjin nr. 7961, date 12.07.1995, i ndryshuar, Kodi i Punes, Kreu V, neni 12, specifikohet: Kontrata e punes eshte nje marreveshje ndermjet punemarresit dhe punedhenesit, qe rregullon marredheniet e punes dhe permban te drejtat dhe detyrimet e paleve. Ne kontraten e punes punemarresi merr persiper te ofroje punen ose sherbimin e vet per nje periudhe te caktuar ose te pacaktuar kohe, ne kuader te organizimit dhe te urdhrave te nje personi tjeter, te quajtur punedhenes, i cili merr persiper te paguaje nje shperblim. Ligji nuk e ka te percaktuar formen noteriale te lidhjes se kontrates, mjafton forma e rregullt ligjore ne perputhje me dispozitat e parashikuara ne kodin e punes.*

*Gjithashtu lejohet lidhja e kontratave ndermjet punedhenesit dhe punemarresit me kohe te pjesshme dhe ky i fundit gezon te njejtat te drejta si punemarresit me kohe te plote.*

*Referuar neni 21 te Kodit te Pones thuhet ne menyre te shprehur se:Kontrata e punes mund te lidhet me goje ose me shkrim. Ajo mundte ndryshohet vetem ne marreveshje midis paleve. Cdo ndryshim i kontrates se shkruar, ne dem te punemarresit, duhet te perfundohet me shkrim,"; me sa shihet nuk ka nje moment ku te jete shprehur per domosdoshmerine e formes ad substantiam me akt noterial. Garancia ligjore qe ligji i ka vene kesaj kontrate eshte maksimalisht me shkrese, pra pranohet dhe verbalisht. Duke u nisur nga kjo dispozite ne kuptojrne se ligjvenesi ka dashur te lehtesoje sa me shume proceduren e kontraktimit te punemarresit, si per favorizim te ketij te fundit po ashtu edhe lehtesi te punedhenesit. Ratio leges i mos kushtezimit te formes se kontrates se punes eshte shume i kuptueshem, pasi ligji duhet t'i vije ne ndihme subjektit dhe jo anasjelltas, qe do te thote nuk mund te shpjegohet perforcimi i standarteve te vendosura nga Autoriteti Kontraktor, kur legjislatori ka maksimizuar formen deri ne kontraten me shkrim. Sipas teorise te se drejtes ne lidhje me formen e veprimit juridik, domosdoshmeria e saj eshte per te provuar vullnetin e paleve ne kete marredhenie, ne rastin konkret ligjvenesi kushtezohet ne formen verbale ose me shkrese, duke lene ne vleresim te paleve zgjedhjen e formes ose me goje ose me shkrim por jo me shume se sa kaq, pasi e ka gjetur me vend se mund te sjelle pasoja juridike ky veprim juridik mjafton me kete te jete ne mirebesim mes paleve deri ne nivelin e shkreses se nenshkruar bashkarisht.*

*Nder te tjera sjellim ne Vemendjen Tuaj se ky kriter bie ndesh me parimin kushtetues te hierarkise se normave, qe per rrjedhoje jane percaktuar se sipas nenit 116 "Aktet normative", kuptohet se cdo dispozite e meposhtme del ne baze dhe per zbatim te asaj me siper, qe do te thote aktet*

*normative qe jane te renditura me afer bazes se piramides se Kelzen, rregullojne dhe shpjegojne ate cfare maja e piramides parashikon, por nuk mundet kurrsesi, qe nje norme me e vogel ne fuqine vertikale te saj, te krijoje norma te reja te cilat nuk jane te rregulluara me lart.*
*Konkretisht DST eshte nje dokument institucional qe del ne baze dhe per zbatim te ligjeve, qe do te thote nuk mundet Autoriteti Kontraktor me ane te DST te krijoje apo te ndryshoje ligjet, pasi fuqia juridike e DST mbetet vetem per fushen e veprimtarise qe ka dhe objektin qe rregullon. Detyrimi per te patur punonjesit e stafit mbeshtetes kontrate pune me akt noterial eshte pretendim i pabazuar ne ligj dhe i pashpjegueshem. Pamundesia apo frika e cdo subjekti te ligjit per shkelje te ligjit nuk justifikon mjetet joligjore te perdorura per realizimin e te drejtes. Ne kuader te parimit te proporcionalitetit te parashikuar ne nenin 17 te Kushtetues, thuhet se kufizimi i te drejtave duhet te justifikohet per shkakun te cilin behet dhe kjo vetem per interesa publike dhe me ligj. Ne rastin konkret nuk jemi para asnjerit kusht ligjor per te justifikuar ndryshimin e formes se kontrates se pones, per te cilen e ka mjaftueshem dispozita sqaruese dhe rregulluese te kesaj marredhenie juridike dhe nuk ka shkak pse te kete konfondim.*
*Ne nenin 14 specifikohet: 1. Me kontraten e punes me kohe te pjesshme, punemarresi pranon te punoje me ore, gjysme dite pune ose dite pune, per nje kohezgjatje normale javore ose mujore me te vogel se ajo e punemarresve qe punojne me kohe te plote ne te njejtat kushte. 2. Punemarresit me kohe pune te pjesshme gezojne te njejtat te drejta, si punemarresit me kohe te plote qe kryejne te njejten pune. Nese kushtet e punesimit kane lidhje te drejperdrejte me kohen e punes se punemarresit, punemarresi me kohe te pjesshme gezon te drejta perpjestimore me punemarresit me kohe te plote, perpjestimisht si punemarresi me kohe te plote pune. Mbeshtetur ne VKM nr. 914, date 29.12.2014 , i ndryshuar dhe LPP i ndryshuar, nuk specifikohet ne asnje nen asnje kriter ku ndalon konkurrimin e operatoreve ekonomike qe kane te punesuar me kohe te pjesshme disa nga punonjesit.*
*Ne keto kushte kerkojme modifikimin e ketij kriteri te vendosur ne kundershtim te hapur me kerkesat Ligjore qe parashtruam me lart, por edhe ne kundershtim te hapur me dispozitat ligjore. Per reference KPP 411/2020, date 02.10.2020.*
*Kerkojme te hiqet kerkesa per paraqitjen e kontratave noteriale te punes per punonjesit.*
*Fryma dhe qellimi i ligjit eshte te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit, te siguroje nje trajtim te barabarte te tyre ndaj, e ne funksion te kesaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet te jene pikerisht ne funksion te ketyre parimeve",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.4.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", pika 3, gërma "e ", nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:
*e. Krahas stafit te mesiperm te kete te punesuar staf mbeshtetes si me poshte:*
*- Inxhinier Ndertimi profili strukturist – 1;*
*- Inxhinier Telekomunikacion – 1;*
*-Teknik Gjeometer -1;*
*-Teknik Hidroteknike – 1*
*-Teknik ndertimi – 3;*
*-Teknik Topograf -1;*
*-Teknik Mekanik -3;*

*- Agranom -1;*
*- Hekurkthyes -1;*
*- Hidraulik  -2;*
*-Murator- 2*
*-Suvatues - 2*
*-Specialist kamerash -2*
*-Specialist IT – 2*
*-Ndertimtari -1*
*- Elektricist -2;*
*- Bojaxhi -1;*
*- Karpentier -2;*
*- Pllakashtrues -1;*
*- Specialist per ndihmen e pare – 1;*
*- Specialist Saldator  -4*
*-Specialist Sistem Ngrohje Ftohje -1*
*- Automakinist - 2 ;*
*- Shofer - 4 ;*
*- Eskavatorist me goma dhe zinxhir/ Manovrator – 5;*
*Operatori ekonomik te paraqes per stafin e mesiperm kontratat noteriale te punes, diplome dhe ose kualifikimin perkates per secilin punonjes. Deshmia e kualifikimit dhe/ose diploma te jete e leshuar nga institucione te licensuara shteterore Arsimore Profesionale. Stafi i mesiperm te figuroje ne listepagesat e shoqerise minimalisht  muajt e fundit (Shtator 2020-Tetor 2020- Nentor 2020).*
** Mos paraqitja e kontrave te nenshkruara perpara noterit mes paleve kontratore do te jete kusht skualifikues.*
** Ne rastin e paraqitjes se kontratave kolektive detyrimisht te jene konform nenit 160 te Kodit te Punes sipas parashikimeve ligjore ne fuqi.*

III.4.2. Në nenin 46, pika 1 gërma “b” i ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se

: “*1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: “b. aftësia teknike: operatorët ekonomike vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike , aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”*

III.4.3. Në nenin 26, pika 8/b, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet:

*"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit;dhe/ose*

III.4.4. Lidhur me pretendimin mbi kërkesën e autoritetit kontraktor, për paraqitjen e kontratës noteriale të punës, Komisioni sqaron se, në Republikën e Shqipërisë, marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës së Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, i cili në nenin 12 të tij parashikon se, kontrata e punës është një marrëveshje ndërmjet punëmarrësit dhe punëdhënësit, që rregullon marrëdhëniet e punës dhe përmban të drejtat dhe detyrimet e palëve. Në kontratën e punës, punëmarrësi merr përsipër të ofrojë punën ose shërbimin e vet për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohe, në kuadër të organizimit dhe të urdhrave të një personi tjetër, të quajtur punëdhënës, i cili merr përsipër të paguajë një shpërblim". Rregullimet e mëtejshme mbi mënyrën e hartimit dhe formës të kontratës së punës rregullohen nga neni 21 i Kodit të Punës të Republikës së Shqipërisë, i cili inter allia parashikon se *"Kontrata e punës lidhet në formë të shkruar. Ajo mund të ndryshohet me shkrim, nëse palët bien dakord për ta bërë këtë."* Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në asnjë rast nuk parashikohet domosdoshmëria për efekt vlefshmërie e nënshkrimit të kontratës së punës përpara një noteri publik, por mjaftohet që kjo e fundit të jetë e lidhur me shkrim. KPP gjykon se, kërkesa e autoritetit kontraktor që kontratat e punës duhen noteriale, është kufizuese dhe shkakton diskriminim të panevojshëm të operatorët ekonomik pjesëmarrës. Në këto kushte, autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriteret e kualifikimit duke hequr detyrimin që kontratat e punës duhet të jenë domosdoshmërisht noteriale.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.4.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: "*kerkojme te saktesoni numrin e kerkuar per punonjesin teknik gjeometer",* nga shqyrtimi i kritereve kualifikuese rezulton se autoriteti kontraktor ka parashikuar kërkesën për një teknik gjeometer, duke e saktësuar këtë numër me 1 (një) punonjës.

Pretendimi i ankimuesit nuk qëndron.

III.5. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: "*Se pesti kundershtojme piken Operatori te disponoje mjetet e meposhtme:*

| | | |
|---|---|---|
| *Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 3 -5 ton* | *copë 4* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobetoniere* | *copë 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobot uji* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik Prodhimi Asfalti* | *copë 1* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes mbi 20 ton* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Greider (me targa )* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 1.5-2 ton* | *Cope 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Rrul* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |

| | | |
|---|---|---|
| *Autobitumatrice* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Nivelues betoni (helikopter)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Minieskavator* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamion me vinc kapacitet mbajtes 6.5 - 8.5 ton* | *copë 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fadrom ( kove para dhe krahe mbrapa)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 10 - 12 ton* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Eskavator me goma (me targa)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autopompe betoni* | *cope 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik prodhim Inertesh* | *copë 1* | *Pronesi,Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Fabrik Prodhimi Betoni* | *copë 1* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Kantier ndertimi (zyre)* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik Prodhimi Fino* | *copë 1 (nje)* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Fabrik Prodhimi Koll* | *copë 1 (nje)* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Betoniere kantier* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *GPS* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Vinç karrel* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Rimorkiator per levizjen e mjeteve* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Sistem Ëell Point* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Prerese pllakash* | *Cope 4* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Trapan* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Vibrator betoni* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Makineri vijezimi* | *Cope 1* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Matrapik* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Skeleri* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Rrjete mbrojtese* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Betonforma* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Pompe suvatimi* | *Cope 3* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Mjete mbrojtese* | | |
| *Kokore* | *110 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fikse Zjarri* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Tabela Sigurimi Teknik* | *20 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Jelek* | *110 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kuti Ndihme e shpejt* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |

| | | |
|---|---|---|
| *Elemet sinjalistike* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Prozhektor per ndricim* | *2 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |

*Ne DST kerkohen nje numer shume i madh makinerish dhe pajisjesh te cilat jane shume te tepruara per nje volum te tille punimesh. Mbeshtetur ne analizen e punimeve te parashikuara nga ju ne preventiv dhe mbeshtetur ne Manualin e miratuar vkm nr.629 date 15/07 2015, perkatesisht ne kapitullin e makineri - pajisjeve inxhinieret tane arriten ne konkluzionin qe makinerite e kerkuara nga ana juaj jane te pajustifikuara dhe kerkojme te hiqen makinerit dhe pajisjet e teperta nga kerkesat per kualifikim dhe vendosjen e tyre ne perputhje me normat e shfrytezimit te makinerive ne analizat teknike te zerave te punes qe jepen ne VKM nr 629 date 12 15/07/2015 "Per miratimin e manualeve teknike te cmimeve te punimeve te ndertimit dhe te analizave teknike te tyre" Me poshte sqarimi per mjetet e teperta:*

*Greider (me targa) cope 1*

*Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike cope 1*

*Kerkesa per Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike eshte e tepert per kete objekt, duke ditur qe kemi te bejme me rikonstruksion objekti dhe ku lartesia maksimale e objektit te prokurimit eshte 17 metra. Ky objekt mund te realizohet edhe me mjete vinc karel te cilat edhe Ak i ka kerkuar ne listen e disponueshmerise se mjeteve. Ky lloj autovinci qe ka kerkuar autoriteti kontraktor perdoret per montim trare urash, soleta urash ose per objekte me lartesi mbi 30m.*

*Per me teper ky lloj autovinci nuk gjendet ne Republiken e Shqiperise, por vetem ne Itali. Kerkojme heqjen e kerkeses per Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike.*

*Per grejderin kerkojme modifikimin qe ky mjet duhet te jete i patarguar. Per kete ju veme ne dispozicion vendimin: KPP eshte shprehur ne vendim:*

*"pikat 2, 3, 4 dhe 5 te nenit 113 i Ligjit Nr. 8378, date 22.7.1998 "Kodi Rrugor i Republikes se Shqiperise", i ndryshuar, parashikojne: "2. Per te qarkulluar ne rruge makinat teknologjike duhen regjistruar ne zyrat e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, qe i leshojne lejen e qarkullimit atij qe verteton se eshte pronari i mjetit;*

*3. Per te qarkulluar ne rruge makinat teknologjike duhen respektuar dispozitat e neneve 98, 106, 107, 110 dhe 111. Makinat teknologjike qe, per kerkeea funksionale, i tejkalojne permasat gabarite kufitare dhe peshat kufitare te percaktuara ne nenet 61 dhe 62, konsiderohen makina teknologjike jashte norme dhe per to zbatohen normal e parashikuara ne nenin 103, pika 8;4. Per te qarkulluar ne rruge makinat teknologjike vetelevizese dhe ato qe terhiqen, duhet te jene te pajisura me nje large njohjeje, e cila permban te dhenat e regjistrimit; 5. Menyrat e zbatimit te pikave 2 dhe 3, si dhe ato qe kane te bejne me modifikimet ne emertimin e mjeteve, permbajtjen dhe karakteristikat e lejes se qarkullimit, jane percaktuar me udhezime te organeve te Ministrise se Puneve Publike dhe Transportit." Nga interepretimi literal i nenit te sipercituar, konstatohet qarte se per regjistrimin e mjeteve teknologjike ne zyrat e Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor si dhe per pajisjen me targe njohje, leje qarkullimi dhe gjithe dokumentacionin lidhur me to, detyrimi ligjor lind vetem ne rastet kur mjetet teknologjike qarkullojne ne menyre vetelevizese ne rruge. Pra, ne asnje rast, legjislacioni ne fuqi per transportin rrugor ne Republiken e Shqiperise, nuk detyron pronaret e mjeteve teknologjike qe ti regjistrojne ato prane zyrave te Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, e per rrjedhoje te pajisen me targe njohje, leje qarkullimi etj, persa kohe*

*ato transportohen me mjete te tjera dhe perdoren vetem ne kantier. Ne keto kushte, KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues e ka plotesuar kerkesen e autoritetit kontraktor ne drejtim te disponueshmerise se makinerive",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.5.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

***1.*** ***<u>Operatori te disponoje mjetet e meposhtme:</u>***

| | | |
|---|---|---|
| *Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 3 -5 ton* | *copë 4* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobetoniere* | *copë 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobot uji* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik Prodhimi Asfalti* | *copë 1* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes mbi 20 ton* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Greider (me targa )* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamioncine vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 1.5-2 ton* | *Cope 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Rrul* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autobitumatrice* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Nivelues betoni (helikopter)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Minieskavator* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamion me vinc kapacitet mbajtes 6.5 - 8.5 ton* | *copë 3* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autovinc me krah horizontal mbi 40 ml me skede teknike* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fadrom ( kove para dhe krahe mbrapa)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kamion vetëshkarkues, kapacitet mbajtes 10 - 12 ton* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Eskavator me goma (me targa)* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Autopompe betoni* | *cope 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik prodhim Inertesh* | *copë 1* | *Pronesi,Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Fabrik Prodhimi Betoni* | *copë 1* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Kantier ndertimi (zyre)* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fabrik Prodhimi Fino* | *copë 1 (nje)* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Fabrik Prodhimi Koll* | *copë 1 (nje)* | *Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi* |
| *Betoniere kantier* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *GPS* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Vinç karrel* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Rimorkiator per levizjen e mjeteve* | *copë 2* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Sistem Ëell Point* | *copë 1* | *Ne pronesi ose me qera* |

| | | |
|---|---|---|
| *Prerese pllakash* | *Cope 4* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Trapan* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Vibrator betoni* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Makineri vijezimi* | *Cope 1* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Matrapik* | *Cope 2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Skeleri* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Rrjete mbrojtese* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Betonforma* | *1000 m2* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Pompe suvatimi* | *Cope 3* | *Ne pronësi ose me qira* |
| *Mjete mbrojtese* | | |
| *Kokore* | *110 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Fikse Zjarri* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Tabela Sigurimi Teknik* | *20 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Jelek* | *110 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Kuti Ndihme e shpejt* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Elemet sinjalistike* | *10 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |
| *Prozhektor per ndricim* | *2 Cope* | *Ne pronesi ose me qera* |

*Per te deshmuar kete, Formulari i shtojces 9 te DST duhet te shoqerohet me dokumentat e meposhtme:*

- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:*
  *- çertifikaten e pronesise;*
  *-leja e qarkullimit;*
  *-çertifikaten e kontrollit teknik;*
  *- siguracionin;*
  *- taksat vjetore*
  *- leja e transportit dhe fotot perkatese;*
  *ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.*

*Per mjetet dhe paisjet e tjera qe nuk pajisen me leje qarkullimi, ofertuesi duhet te paraqese kontrate noteriale te blerjes ose fatura tatimore te blerjes ose dokument zhdoganimi te mjetit ose kontrate qeraje.*

*Deklaratë me shkrim nga administratori i shoqërisë mbi vendodhjen e mjeteve.*

*Fabrika prodhimi i betoni Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje shfrytezimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB.*

*Fabrika prodhimi i inerteve Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje shfrytezimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB.*
*Fabrika prodhimi i Asfaltit Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje shfrytezimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB.*
*Fabrika prodhimi i Fino, Koll, ne Pronesi, Kontrate Qeraje, Kontrate Furnizimi te jene te pajisura me (Leje shfrytezimi, plane vendosje, leje mjedisore, QKL Kodi III.1.B dhe ISO 9001- 2015 (Sistemi i Menaxhimit te Cilesise) Furnizusi te kete status aktiv ne QKB.*
*Grafiku i punimeve, ku zërat e punës, fuqisë punëtore dhe numrit të mjeteve të jetë në përputhje me afatin kohor në dokumentet e tenderit.*

III.5.2. Nëpërmjet shkresës nr. 70/12 prot., datë 22.12.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankimuesit si vijon: *Referuar pretendimit te operatorit ekonomik mbi mjetet ju bejme me dije se: Kriteri per mjetet dhe paisjet teknike eshte vendosur ne mbeshtetje te Ligjit 9643, date 20.11.2006 "Per Prokurimin publik", (i ndryshuar) Neni 46, pika 1, germa (b), si dhe ne germen (c) te pikes 8 te Nenit 26, Seksioni II, Kreu III te VKM Nr. 914 date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik (i ndryshuar) ku citohet: " 8. Per te provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kerkon: a) deshmi per mjetet e pajisjet teknike, qe ka ne dispozicion apo qe mund t'i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik per te permbushur kontraten".*
*Ne mbeshtetje te dispozites ligjore te sipercituar Ligjvenesi i jep te drejten Autoritetit kontraktor te kerkoje nga ana e Operatoreve ekonomik deshmi per mjetet dhe paisjet teknike eshte vleresuar si te domosdoshem paraqitjen e deklaratave dhe dokumentacionit perkates ne lidhje me mjetet dhe paisjet teknike qe Operatori ekonomik disponon ne funksion te realizimit te kontrates objekt prokurimi. Cdo mjet i percaktuar sa me siper eshte kerkuar ne funksion te kryerjes se zerave specifike te punimeve, ndersa numri i mjeteve eshte percaktuar ne varesi te volumeve te punimeve. Gjithashtu ne reference te frymes se ligjit per prokurimin publik dhe konkretisht te nenit 46 / 1 /b, i cili percakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshem, vertetojne se zoterojne kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makinerite, pajisjet e asete te tjera fizike, aftesite organizative, reputacionin dhe besueshmerine, pervojen e duhur, si dhe personelin e nevojshem, per te zbatuar kontraten.*
*Sa me siper pretendimi juaj nuk qendron."*

III.5.3. Në nenin 46, pika 1 gërma "b" të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

*"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese. b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin*

*e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;"*

III.5.4. Neni 26, pika 8, e Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar, parashikon shprehimisht se : Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon*:*

*a) licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*

*b) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*c) dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën*

III.5.5. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapacitetetev të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion realizimit me sukses të kontratës. Në këtë kuptim, për autoritetin kontraktor është e rëndësishme të provohet që operatori ekonomik zotëron kapacitetet teknike (makineritë), në përputhje me volumin e përcaktuar në dokumetat e tenderit. Komisioni i Prokurimit Publik, pas analizimit të preventivit të punimeve që do të kryehen në objektin e prokurimit, si dhe volumit të kontratës, gjykon se kërkesa e autoritetit kontraktor mbi disponimin e autovincit me krahë të gjatë është e lidhur ngushtë dhe në përputhje me volumin e kontratës objekt prokurimi, për shkak të punimeve që do të kryhen. Por, Komisioni gjykon se, përcaktimi i gjatësisë së krahut horizontal të Autovincit jo më pak se 40 ml, është e ekzagjeruar dhe aspak e justifikuar nga autoriteti kontraktor.

III.5.6. Gjithashtu, Komisioni gjykon se, edhe përcaktimi *Greider (me targa )*, është kërkesë kufizuese, si dhe nuk i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar bindjen mbi kapacitetin e operatorëve ekonomik lidhur aftësinë zbatuese të kontratës, pasi në kriteret kualifikuese autoriteti kontraktor ka parashikuar që për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit: - çertifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -çertifikaten e kontrollit teknik; - siguracionin; - taksat vjetore; - leja e transportit dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve. Gjithashtu autoriteti kontraktor ka parashikuar në dokumentat e tenderit që për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithe periudhen e realizimit te punimeve deri ne perfundimin e plote te punimeve.

Në këto kushte, Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor duhet të modifikojë kriterin e mësipërm duke hequr përcaktimin e “me targë” për greiderin, si dhe duke ulur kufirin e gjatësisë të krahut për autovincin.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.6. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “*Se gjashti kundershtojme piken: Operatori ekonomik te kete Licence per Stacion Transfermi per mbetje jo te rrezikshme (stacionimin e dherave sipas germimit) Kodi III.I.A ne mbeshtje te vendimit te Keshillit te Ministrave VKM Nr. 419, Date 25/6/2014dhe Ligj Nr. 104448, Date 9/6/2011. Neni 1 i LPP parashikon shprehimish se: "Qellimi i ketij ligji eshte: a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore; b) te siguroje mireperdorim te fondeve pub like dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; 9) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik si dhe dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik. Neni 4 i Ligjit nr. 10448, date 14.7.2011 "Per lejet e mjedisit": "Ne perputhje me ligjin nr.10431, date 9.6.2011 "Per mbrojtjen e mjedisit", krijohet nje sistem prej tri nivelesh te lejeve te mjedisit, te tipit A, B e C, si me poshte: a) leja e mjedisit e tipit A eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise A, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcen 1/A te ketij ligji; b) leja e mjedisit e tipit B eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise B, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcen 1/B te ketij ligji; c) leja e mjedisit e tipit C eshte e detyrueshme per kryerjen e veprimtarive te kategorise C, lista dhe pragjet perkatese te te cilave jane percaktuar ne shtojcen 1/C te ketij ligji". VKM nr. 538, date 26.5.2009 "Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet QKL dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa", Aneksi 1 "Kategorite e licencave e lejeve qe si rregull trajtohen nga ose nepermjet QKL-se, Fusha III "Mjedisi dhe burimet mjedisore baze", Kategoria III.I "Per ndikimin ne mjedis": "1. Lejet mjedisore te percaktuara ne 34 pika 5 e ligjit nr. 8934, date 5.9.2002 "Per mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar, bejne pjese ne kategorine III.1 te shtojces se ligjit nr.10 081, date 23.2.2009 "Per licencat, autorizimet dhe lejet ne Republiken e Shqiperise" 11.2. Lejet e ndikimit ne mjedis ndahen ne tre nenkategori si vijon: a) "Leje e thjeshte mjedisore" me kodin III. I.A; b) "leje mjedisore" me kodin III.1.B; c) "leje e integruar mjedisore" me kodin III.1.C. "*

*Nga gjithe dispozitat e mesiperme konstatohet se: Objekti i prokurimit permban: Grumbullim, transport, depozitim, trajtim i mbetjeve qe perfshin ne vetvete edhe sherbimet e fshirjes dhe lajres se rrugeve. Pra, leja mjedisore per kete objekt qe leshohet nga QKL, eshte ajo me kodin III.I (A, B, ose C) dhe pershkrimi ne te i operacioneve te cilat mbulon eshte sipas emertimeve te percaktuara ne Shtojcen 1 "Lejet e mjedisit te tipave A, B dhe C ne varesi te kapacitetit prodhues kufi", te ligjit nr.10448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar, konkretisht ato te percaktuara ne kete Shtojce ne piken "Menaxhimi i mbetjeve", me nr. 5.1- 5.11. Nga dispozitat ligjore te sipercituara, ne referim te Shtojces 1 te ligjit nr.10448, date 14.7.2011, "Per lejet e mjedisit", te ndryshuar, rezulton qarte, se cilat jane aktivitetet qe pajisen me leje mjedisore (te tipit A, B, ose C) ne fushen e menaxhimit te mbetjeve. Ne kete kontekst, sipas Shtojces I te*

*sipercituar, leja mjedisore sipas objektit te kontrates leshohen per aktivitetet ne pikat 5.3.(c), (d) ose (e) te Shtojces 1 te ligjit nr.10448, date 14.7.2011, me kod III.1.B ose III.1.C.*
*Lidhur me III.I.A tipi C eshte absolutisht e panevojshme per kete procedure. Ky kriter eshte abuzues nga ana juaj dhe tregon qe kriteret jane te paracaktuara. Sqarojme se mbetjet jo te rrezikshme te cilat dalin nga proceset e punes se rikonstruksionit ne objekte do te depozitohen ne grumbullimet e autorizuar ne qarkun ku ekzekutohet procedura dhe per kete lidhet marreveshje me firmen e cila merret me grumbullimin e tyre ne Bashkine e Elbasanit. Bashkia Elbasan e ka te percaktuar vendodhjen e grumbullimit te mbetjeve jo te rrezikshme. Per me teper Stacion trancferimi per mbetjet jo te rrezikshme me kodin III.I.A tipi C eshte vetem nje operator ekonomik ne qarkun tuaj. Pra ju e keni paracaktuar fituesin ?! Kerkesa e autoritetit kontraktor qe lejen mjedisore tip C, leshuar nga Qendra Kombetare e Licensimit per stacion transferimi per mbetje jo te rrezikshme (Kodi III. I .A), duhet ta disponoje vetem operatori ekonomik pjesemarres, eshte nje kerkese qe shkakton kufizim te panevojshem, pasi shume operatore ekonomik te cilet mund te disponojne te gjitha kapacitetet dhe kualifikimet e nevojshme per zbatimin me sukses te punimeve, penalizohen vetem per faktin qe nuk disponojne stacion transferimi mbetjesh. Ne keto kushte, me qellim hapjen e gares dhe zgjerimin e rrethit te pjesmarrjes se operatoreve ekonomike ne respekt te nenit 1, pika 2, te LPP i cili parashikon shprehimisht se: "2. Qellimi i ketij ligji eshte: a) te rrise eficencen dhe efikasitetin ne procedurat e prokurimit publik, te kryera nga autoritetet kontraktore; b) te siguroje mireperdorim te fondeve publike dhe te ule shpenzimet procedurale; c) te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit publik; c;) te nxise konkurrencen ndermjet operatoreve ekonomike; d) te siguroje nje trajtim te barabarte dhe jodiskriminues per te gjithe operatoret ekonomike, pjesemarres ne procedurat e prokurimit publik; dh) te siguroje integritet, besim publik dhe transparence ne procedurat e prokurimit publik.*
*Kerkojme heqjen e ketij kriteri abuzues, diskriminues dhe kufizues i pjesemarrjes se lire te operatorev ekonomike eshte absolutisht i panevojshem.*
*",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.6.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

*Operatori ekonomikte kete Licençe per Stacion Transfermi per mbetje jo te rrezikshme (stacionimin e dherave sipas germimit) Kodi III.1.A ne mbeshtje te vendimit te Keshillit te Ministrave VKM Nr. 419, Date 25/6/2014 dhe Ligj Nr. 104448, Date 9/6/2011.*

III.6.2. Në përgjigjen e kthyer ankimuesit nëpërmjet shkresës nr. 70/12 prot., datë 22.12.2020 autoriteti kontraktor ka argumentuar: "*Referuar pretendimit te operatorit ekonomik mbi lejen stacionare, ju bejme me dije se: Ky kriter eshte vendosur ne zbatim te zerave te preventivit te cilet permbajne nje sasi te konsiderueshme te transportit te mbeturinave dhe dherave te cilat dalin gjate procesit te germimit dhe rikonstruksionit. Ne kete menyre operatoret ekonomike te cilet jane te pajisur me licensen per stacion tranferimi per mbetje jo te rrezikshme e kane me te lehte menaxhimin e mbeturinave urbane te dala gjate punimeve.*
*Sa me siper pretendimi juaj nuk qendron."*

III.6.3. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar parashikohet se:

*"Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

III.6.4. Në nenin 26 pika 8 gërma "a" të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për Rregullat e Prokurimit Publik*", i ndryshuar, parashikohet shprehimisht:

*"Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose."*

III.6.5. Në Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, "*Për Lejet e Mjedisit*", në nenin 1 dhe 2 "*Qëllimi dhe Objekti*", parashikohet shprehimisht:

*"Ky ligj ka për qëllim parandalimin, pakësimin dhe mbajtjen nën kontroll të ndotjes së shkaktuar nga disa kategori veprimtarish, në mënyrë që të arrihet një nivel i lartë i mbrojtjes së mjedisit në tërësi, shëndetit të njeriut dhe cilësisë së jetës".*

*Ky ligj përcakton:*

*a) rregullat për lejimin e zhvillimit të disa veprimtarive që shkaktojnë ndotje të mjedisit në Republikën e Shqipërisë;*

*b) masat e parashikuara për parandalimin e kësaj ndotjeje dhe, kur kjo nuk është e mundur, masat për pakësimin e shkarkimeve të tyre të gazta, të lëngëta e të ngurta në ajër, ujë e tokë."*

III.6.6. Në neni 4 "*Sistemi i lejeve të mjedisit*" të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, "*Për Lejet e Mjedisit*", parashikohet shprehimisht:

"*1. Në përputhje me ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", krijohet një sistem prej tri nivelesh të lejeve të mjedisit, të tipit A, B e C, si më poshtë:*

*a) leja e mjedisit e tipit A është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë A, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/A të këtij ligji;*

*b) leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji;*

*c) leja e mjedisit e tipit C është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë C, lista dhe pragjet përkatese të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/C të këtij ligji."*

III.6.7. Në shtojcën 1 "*Lejet e mjedisit të tipave A, B dhe C në varësi të kapacitetit prodhues kufi*" të Ligjin Nr 10448, datë 14.07.2011, "*Për Lejet e Mjedisit*", përcaktohet:

”*Kur një operator kryen veprimtari të ndryshme nën të njëjtin nëntitull si më poshtë dhe nën të njëjtin nëntitull Si më poshtë dhe në të njëjtin instalim ose në të njëjtën vendndodhje, kapacitetet e këtyre veprimtarive mblidhen bashkë. Nqs nuk përcaktohet ndryshe, në tabelën e mëposhtme, kapaciteti* ***kufi*** *nënkupton kapacitetin e plotë prodhues të asaj veprimtarie, pavarësisht nga fakti nëse ai shfrytëzohet plotësisht apo jo. [...]*

III.6.8. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përketë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik. Sa i përket argumentit të autoritetit kontraktor se *operatoret ekonomike te cilet jane te pajisur me licensen per stacion tranferimi per mbetje jo te rrezikshme e kane me te lehte menaxhimin e mbeturinave urbane te dala gjate punimeve,* Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Njësia e prokurimit pranë autoriteti kontraktor, e cila në mbështetje të nenit 57 ("Njësia e prokurimeve"), pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", është struktura përgjegjëse për *"...përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme",* duhet të marrë masa për modifikimin e kriterit në fjalë, duke lejuar edhe alternative të tjera, të cilat realizojnë *menaxhimin e mbeturinave urbane te dala gjate punimeve,* me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së subjekteve në procedurën e prokurimit për përmbushjen e nevojave të autorititetit kontraktor me kosto sa më optimale.

Gjithashtu Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 "*Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës*" të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t'u siguruar nëse cilësia e punimeve, shërbimeve dhe angazhimet e ofruara do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe angazhimet e premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penalitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron pjesërisht.

III.7. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: "*Se shtati kundershtojme piken "HDPE, PVC, Korrogato dhe PE, plastike sipas preventivit, kontrata e tubove te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, katalogun, ISO 9001-2008, te dhenat teknike, makinerite e prodhimit te tubove, QKB, certifikata e cilesise se proves, KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi i plastikes).*
*Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi kur nuk eshte vete prodhues, per Pllaka, sipas preventivit, kontrata e tubave te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, certifikate ISO 9001:2015, makinerite e prodhimit dhe licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI III.1.A, Deklarate konfirmimi. Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi kur nuk eshte vete prodhues, per Bar sipas preventivit, kontrata e barit te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, certifikate ISO 9001:2015, licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI II.4, Deklarate konfirmimi."*
*Ne kriterin sa me siper autoriteti kontraktor duhet te kerkoje qe per pajisjet e parashikuara ne preventiv qe do te vendosen ne veper, operatoret ekonomike te paraqesin autorizim prodhuesi ose distributori por duhet te heqe nga kriteri te gjithe elementet e tjere si certifikatat e prodhuesit si dhe specifikimet teknike te pajisjeve qe ne kete faze te procedures jane te tepruara dhe mbingarkojne se tepermi operatoret ekonomike per me teper eshte abuzive nga ana e autoritetit kontraktor kerkesa per "KODI III.I.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi i plastikes, QKLKODI II.4 makinerite e prodhimit dhe licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI III.1.A, Deklarate konfirmimi.*
*licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI II.4, Deklarate konfirmimi"*
*Autoriteti kontraktor per mbarevajtjen e punes ka te drejte te kerkoje standarte mbi produktin autorizim prodhuesi/distributori zyrtar si dhe kataloge mbi keto produkte por jo te kerkoje dokumenta, [QKB, certifikata e cilesise se proves, KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi i plastikes)]. Mos paraqitja e ketyre QKL per riciklim plastikes dhe perpunimin e plastikes te prodhuesit nuk ndikon ne ekzekutimin me sukses te procedures.",* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.7.1. Në shtojcën 12 "Kriteret e vecanta të kualifikimit", "Kapaciteti teknik", nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar si vijon:

*Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi kur nuk eshte vete prodhues, per tubo HDPE, PVC, Korrogato dhe PE, plastike sipas preventivit, kontrata e tubove te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, katalogun, ISO 9001-2008, te dhenat teknike, makinerite e prodhimit te tubove,QKB,certifikata e cilesise se proves, KODI III.1.B (riciklim plastic), KODI III.1.A (prodhimi i produkteve plastike), KODI III.2.B (perpunimi i plastikes).*

*Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi kur nuk eshte vete prodhues, per Pllaka, sipas preventivit, kontrata e tubave te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, certifikate ISO 9001: 2015, makinerite e prodhimit dhe licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI III.1.A, Deklarate konfirmimi.*

*Operatori Ekonomik duhet te paraqese kontrate furnizimi kur nuk eshte vete prodhues, per Bar sipas preventivit, kontrata e barit te jete e shoqeruar me kontrate furnizimi, certifikate ISO 9001: 2015 , licence per ushtrimimin e ketij aktiviteti QKL KODI II.4, Deklarate konfirmimi.*

III.7.2 Në përgjigjen e kthyer ankimuesit nëpërmjet shkresës nr. 70/12 prot., datë 22.12.2020 autoriteti kontraktor nuk ka dhënë asnjë sqarim lidhur me pretendimet e ankimuesit. Po kështu edhe në informacionin e dhënë Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës 70/16, datë 07.01.2021 autoriteti kontraktor nuk ka argumentuar arsyet e përcaktimit të këtyre kërkesave objekt ankimi, në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014, neni 61, sipas të cilit *dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. [...]Në çdo rast, hartimi i kritereve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*

III.7.3. Në nenin 46 pika 1 gërma "a" e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "*Për Prokurimin Publik*" i ndryshuar parashikohet se:

*"[...] Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese: a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;*

III.7.4. Komisioni i Prokurimit Publik, nisur nga sa më lart, vlerëson se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Bazuar në ligjin dhe rregullat e prokurimit publik, si dhe në ligjin dhe udhëzimet kombëtare përkatëse përsa i përketë rastit konkret është në të drejtën e autoritetit kontraktor të përcaktojë kriteret për kualifikim, në përputhje me dispozitat ligjore gjithnjë kur ato janë të nevojshme dhe të lidhura ngushtë me objektin e prokurimit, bazuar në legjislacionin për prokurimin publik duke mos i tejkaluar kufijtë maksimalë të përcaktuar në këtë të fundit, në funksion të qëllimit dhe parimeve të ligjit për prokurimin publik. Kriteret për kualifikim vendosen që ti shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, duke mbajtur në konsideratë kufijtë maksimal të përcaktuara në rregullat e prokurimit publik.
Sa më sipër arsyetuar, KPP gjykon se në përgjigje të testit të proporcionalitetit, kërkimi i autoritetit kontraktor mbi disponueshmërinë e kërkesave objekt ankimimi, parë kjo në vlerën dhe natyrën e kontratës që do të prokurohet, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se Njësia e prokurimit pranë autoriteti kontraktor, e cila në mbështetje të nenit 57 (“Njësia e prokurimeve”), pika 2, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, është struktura përgjegjëse për *“...përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe mbledhjen e të gjitha materialeve të nevojshme që u bashkëlidhen atyre, përfshirë hartimin e kritereve të veçanta për kualifikim dhe specifikimet teknike, nëse kjo detyrë nuk i është ngarkuar një strukture të posaçme”,* duhet të marrë masa për modifikimin e kritereve në fjalë, me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes së subjekteve në procedurën e prokurimit për përmbushjen e nevojave të autorititetit kontraktor me kosto sa më optimale.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues qëndrojnë.

III.7.5. Përsa përket pretendimit të ankimuesit për autorizimin e prodhuesit, në rastin konkret, KPP gjykon se objekti i ankesës së operatorit ekonomik ankimues nuk lidhet me kundërshtimin e një vendimi të shprehur nga ana e autoritetit kontraktor (verifikimin ligjor në rast se kriteret kualifikuese janë në proporcion me natyrën dhe volumin e kontratës, apo në rast se specifikimet teknike janë hartuar në formën e kërkuar nga ligji), por mbi shtimin e kritereve kualifikuese në një procedurë prokurimi. KPP gjykon se kuadri ligjor në fuqi ka parashikuar se është në të drejtën e plotë të autoritetit kontraktor të parashikojë kriteret minimale kualifikuese në një procedurë prokurimi dhe në rast se këto të fundit, (vetëm kriteret e shprehura dhe jo ato hipotetike të kërkuara) nuk janë në përputhje me rregullimet ligjore në fuqi, jepet garancia proceduriale e paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.
Sa më sipër, përsa kohë që autoriteti kontraktor nuk ka parashikuar vendosjen e kërkesës për autorizim prodhuesi, KPP në asnjë rast nuk mund të marrë kompetencat e autoritetit kontraktor (njësisë së prokurimit) të shtojë kritere të tjera kualifikuese për marrjen pjesë në procedurat e prokurimit publik.

Pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

III.8. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se: “ *Se teti kundershtojme piken: Ne perputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates, operatori ekonomik duhet te paraqese autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi/distributori, me te cilin prodhuesi/distributori autorizon kompanine pjesemarrese ne tender te ofertoje keto pajisje/mallra ne kete procedure prokurimi, si me poshte:*
*Pllaka*
*Pajisje elektrike*
*Polisterol*
*Hidroizoluese*
*Pajisje mekanike*
*Bojra hidroplastike*
*Pajisje hidraulike*
*Pasjisje hidrosanitare*
*Hekur*
*Kamera*

*Grafiato*
*Dyer dhe dritare*
*Referuar ne nenin 27 pika 1 te Vendimit nr.914 date 29.12.2014 te Keshillit te Ministrave "Per miratimin e rregullave te prokurimit publik", te ndryshuar, parashikohet se: "1. Specifikimet teknike duhet te pershkruajne minimumin ose teresine e elementeve me te rendesishme perberese, qe garantojne cilesine e kerkuar, ne perputhje me nenin 23 te LPP dhe qe i vlereson mallrat si te pranueshme per funksionet e kerkuara." [...]*
*Ne rastin konkret, gjykojme se specifikimet teknike jane hartuar ne menyre qe te drejtojne drejt nje produkti/mall/sherbim qe ofrohen nga nje operator i vetem ekonomik ose nga nje prodhues i vetem.*
*Kerkojme modifikimin e specifikimve teknike sipas projektpreventivit te percaktuar nga projektuesi. Fryma dhe qellimi i ligjit eshte te nxise pjesemarrjen e operatoreve ekonomike ne procedurat e prokurimit, te siguroje nje trajtim te barabarte te tyre ndaj, e ne funksion te kesaj kriteret e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet te jene pikerisht ne funksion te ketyre parimeve. Venia e ketyre kritereve eshte absolutisht diskriminuese dhe kufizuese per te gjithe operatoret e tjere te interesuar per te marre pjese ne gare dhe haptazi ne shkelje te LPP,VKM dhe rekomandimit nr 6732 prot date 21.10.2020 te APP.*
*Ju citojme si me poshte pika 6 e rekomandimit te APP:*
*Operatoret ekonomike ofertues ne nje procedure ne varesi te objektit mund te mos jene detyrimisht prodhues te mallit dhe e sigurojne mallin/sherbimin nga keta te fundit apo distributore te autorizuar prej tyre. Ne kete rast kerkesa per paraqitjen e certifikata te prodhuesit rezulton t'i adresohet paleve te treta (prodhuesit/distributorit) te cilat nuk jane konkurent/kandidat ne proceduren konkrete te prokurimit.*
*Ne kete rast APP rekomandon qe AK te vleresoje mundesine e kerkeses/pranimit te nje vetedeklarimi nga OE ofertues ne kete rast qe prodhuesi eshte konform sitemeve te kerkuara, dhe ne rastin kur OE shpallet fitues AK rezervon te drejten per te kerkuar paraqitjen e certifikatave ne fjale.*
*Ne analize te sa me siper, rezulton qartesisht e provuar se autoriteti kontraktues eshte organi pergjegjes per hartimin e dokumenteve te procedures konkuruese, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi. Ai eshte pergjegjes, pervec hartimit te dokumenteve te procedures konkuruese, dhe per percaktimin e kerkesave per kualifikim, si dhe percaktimin e kritereve te vleresimit. Specifikimet teknike, projekt preventivat pergatiten nga struktura te specializuara per objektin qe do te kontraktohet brenda autoritetit kontraktues, apo edhe jashte tij kur kjo ekspertize mungon. Kjo per faktin se, ligjvenesi ne aktet ligjore dhe nenligjore qe rregullojne mosmarreveshjen objekt shqyrtimi, ka percaktuar ne menyre te pergjithshme kushtet dhe kriteret ligjore qe duhet te permbushen per te pasur nje procedure konkuruese te ligjshme, duke percaktuar se te gjithe operatoret e interesuar per te marre pjese ne keto lloj prokurimesh, duhet te plotesojne keto kushte te cilat kane karakter ligjor, ekonomik-financiar dhe teknik. Ne gjykimin tone persa i perket detajimit te kushteve specifike, projekt preventivit, si dhe percaktimit te kritereve te pergjithshme, ligjvenesi ka ngarkuar per kete qellim autoritetin kontraktues qe organizon dhe zhvillon kete procedure konkurimi eshte edhe organi kompetent qe ka mundesi te plote teknike per ti detajuar keto kritere, ne perputhje me natyren e objektit qe po prokurohet. Per sa me siper, vleresojme se*

*dokumentat standarte te procedures se prokurimit jane edhe aktet themelore mbi bazen e te ciles mund te zhvillohet procedura e prokurimit.*
*Kerkojme modifikimin e ketyre kritereve abuzuese, diskriminuese dhe kufizues i pjesemarrjes se lire te operatorev ekonomike. Ne asnje moment autoriteti kontraktor nuk duhet te percaktoje parametra teknike/ligjore kufizues e perjashtues, por duhet te percaktoje parametra minimale e maximale me qellim pjesemarrjen e nje numri sa me te larte te operatoreve ekonomike te interesuar. Autoritet kontraktore jane te detyruara te zbatojne me perpikmeri dispoziten e mesiperme te LPP-se ne hartimin e specifikimeve teknike dhe kjo duhet pasqyruar edhe ne dokumentet e tenderit",* konstatohet se operatori ekonomik ankimues nuk parashtron fakte apo argumenta të bazuara, por ngre pretendime *a-priori* dhe të përgjithshme në lidhje me kërkesat e mësipërme.
Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*", Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimimit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe "elementet e domosdoshëm të ankesës" sipas përcaktimeve të nenit 20, *"Forma dhe përmbajtja e ankesës",* pika 3, gërma "a"

- *Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;"*

Bazuar në sa mësipër, KPP gjykon se për të mbështetur pretendimet e tij, ankimuesi duhej të kishte shoqëruar ankesën e tij me prova, indicje dhe argumenta, në bazë të të cilave do të shqyrtohej kjo ankesë. Vlen të ritheksojmë se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 52 të LPP dhe nenit 64 e 65 të VKM nr. 914, datë 29.012.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra autoriteti kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Pra, KPP nuk mund të marrë tagrin e autoritetit kontraktor dhe të hartojë e argumentojë të gjitha kriteret e procedurës së prokurimit në themel. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij për hartimin jo të saktë të kritereve kualifikuese. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për hartimin e kritereve të mësipërme në kundërshtim me ligjin dhe rregullat e prokurimit publik.
Në rastin konkret, pesha specifike e barrës për të provuar hartimin e dokumentave të tenderit në kundërshtim me përcaktimet ligjore në fuqi është e plotë dhe qëndron mbi kurrizin e pretenduesit, ndërkohë që KPP adapton një pozicion *re-aktiv*, në pritje të argumenteve të plotë provues se cilat kritere/specifikime teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor janë të gabuara apo diskriminuese. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicje të qarta, mbi të gjithë apo shumicën e elementëve përbërës të dokumentave të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cënon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.
KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si e tillë në vendimarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i

Prokurimit Publik refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik*", i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *"Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*, Neni 4, Vendim i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19"*, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

**Vendos**

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik "Shtatori 90" sh.p.k për procedurën e prokurimit me Nr.REF-81931-12-14-2020 me objekt: "*Rikonstruksion i godinës së Spitalit Prrenjas Librazhd*", me fond limit 25.000.000 lekë, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 15.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Sherbimit Spitalor Librazhd.
2. Autoriteti kontraktor të bëjë modifikimet përkatëse të dokumentave të tenderit në SPE në përputhje me konstatimet e Komisionit të Prokurimit Publik në këtë vendim.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 10 ditëve, të verë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik "Shtatori 90" sh.p.k.
5. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**Nr. 1811 Protokolli**
**Datë 28.12.2020**

**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

| **Nënkryetar** | **Anëtar** | **Anëtar** |
|---|---|---|
| **Enkeleda Bega** | **Vilma Zhupaj** | **Merita Zeqaj** |

Jonaid Myzyri

Digitally signed by Jonaid Myzyri
Date: 2021.01.27 04:17:12 +02'00'

**Kryetar**
**Jonaid Myzyri**